

LUFTA E PPSH PËR REVOLUCIONARIZIMIN E MËTEJSHËM TË SAJ E TË JETËS SË VENDIT

(1966-1971)

1. KONGRESI V I PPSH. DETYRAT PËR REVOLUCIONARIZIMIN E MËTEJSHËM TË PARTISË E TË JETËS SË VENDIT

PPSH shkonte në **Kongresin e saj V** me një bilanc të gjerë lufte parimore kundër revizionizmit modern, sidomos kundër kreut të tij, revizionizmit hrushovian. Nëpërmjet kësaj lufte ajo kishte shkatërruar planet e udhëheqjes kundërrevolucionare sovjetike për ta larguar PPSH nga marksizëm-leninizmi. Kjo luftë përbënte një faktor shumë të rëndësishëm që Shqipëria të mos kthehej prapa, si Bashkimi Sovjetik dhe vende të tjera ish-socialiste, në kapitalizëm, por të ecte gjithnjë përpara në rrugën e socializmit.

Por për të siguruar zhvillimin e pandërprerë të vendit në rrugën e socializmit, krahas luftës kundër revizionizmit modern, kundër imperializmit, kundër rrethimit imperialisto-revizionist, faktor vendimtar ishte lufta për të mos lejuar krijimin e truallit të brendshëm, mbi të cilin mund të lindin dhe të zhvillohen revizionizmi e kapitalizmi. Pa një luftë të vendosur e sistematike kundër mbeturinave të së kaluarës në shoqërinë socialiste, kundër ndikimeve borgjezo-revizioniste në jetën dhe në veprimtarinë e Partisë, të shtetit dhe të masave popullore, kundër shfaqjeve të huaja për ideologjinë proletare e për socializmin, as lufta kundër revizionizmit dhe imperializmit ndërkombëtar s'mund të zhvillohej me sukses.

Për këto arsye, PPSH, duke e forcuar dhe duke e përsosur më tej luftën kundër imperializmit dhe revizionizmit modern, përqendroi vëmendjen në dendësimin dhe përsosjen e luftës **për forcimin e gjithanshëm të rendit socialist nëpërmjet revolucionarizimit të mëtejshëm të jetës së vendit**. Përvoja kishte treguar se kur gjendja brenda vendit është e shëndoshtë, është gjithnjë revolucionare, mënjanohet çdo e keqe që i kanoset socializmit e pavarësisë kombëtare, shkatërrohet çdo presion e ndikim kundërrevolucionar, regresiv, i brendshëm ose i jashtëm, mbi Partinë e mbi popullin.

Revolucionarizimi i mëtejshëm do të përfshinte gjithë fushat e jetës, politike, ekonomike, ideologjike, kulturore, ushtarake, organizative, me pikësynim: të forcohej diktatura e proletariatit, të përsoseshin marrëdhëniet socialiste në prodhim në lidhje organike me zhvillimin me ritme të shpejta të ekonomisë e të kulturës popullore, të forcohej fuqia mbrojtëse e vendit. Theksi do të vihej **në rritjen e ndërgjegjes socialiste** të njerëzve, si kusht i domosdoshëm që ata të kryenin me sukses detyrat e ndërtimit socialist e të mbrojtjes së vendit në stadin e ri të zhvillimit të shoqërisë dhe t'u bënin ballë presioneve të fuqishme të ideologjisë borgjezo-revizioniste nga jashtë.

Bazë e luftës për revolucionarizimin e mëtejshëm do të ishin, si kurdoherë, parimet e marksizëm-leninizmit dhe përvoja revolucionare e Partisë dhe e masave punonjëse.

Vendime me rëndësi historike Tehu i luftës për revolucionarizimin e mëtejshëm të jetës së vendit u drejtua në fillim kryesisht **kundër burokratizmit**.

PPSH kishte zhvilluar një luftë të pandërprerë kundër burokratizmit, duke e parë atë, siç e përcakton Lenini, një armik të socializmit, një sëmundje shumë të rrezikshme që dobëson e shkatërron lidhjet e partisë proletare me masat, që prish diktaturën e proletariatit. Me anë të kësaj lufte ajo nuk kishte lejuar që kjo sëmundje të lëshonte rrënjë në gjirin e saj e të shtetit socialist.

Megjithatë, në punën e organeve të pushtetit, të organeve ekonomike dhe të vetë organeve të partisë viheshin re shfaqje shqetësuese të burokratizmit. Punonjës të ndryshëm të aparateve qendrore e lokale të këtyre organeve u vinin më shumë rëndësi shkresave, rregulloreve, ligjeve se sa punës së gjallë

me njerëzit. Në mjaft raste në veprimtarinë praktike çështjet nuk shikoheshin nga pozita klasore të politikës proletare të Partisë, por me syrin e teknokratit, të zyrtarit profesionist. Dukeshin prirje të fetishizimit të administratës e të masave administrative. Për t'u prerë rrugën të tilla shfaqjeve si edhe rrezikut që ato paraqisnin, dilte e nevojshme që lufta kundër burokratizmit të bëhej më e fortë dhe më e thellë, me metoda më të përsosura revolucionare.

Për zhvillimin e kësaj lufte Partia nxori mësimë edhe nga përvoja e hidhur e Bashkimit Sovjetik, ku burokratizmi përbënte një ndër faktorët kryesorë të degjenerimit e të asgjësimit të diktaturës së proletariatit.

Çështjen e forcimit e të përsosjes së luftës kundër burokratizmit e shqyrtoi Byroja Politike e Komitetit Qendror të Partisë në dhjetor të vitit 1965.

Duke analizuar dhe duke dënuar shtrembërimet burokratike, ajo arriti në konkluzionin se këto shtrembërimë i kishin rrënjët jo vetëm në mbeturinat e së kaluarës, por edhe në nënvleftësimin në praktikë të sëmundjes së rrezikshme të burokratizmit; ato ishin një shprehje e presionit ideologjik e politik të armikut të klasës mbi Partinë dhe aparatën shtetëror. Prania e shfaqjeve burokratike tregonte se rreziku i burokratizmit i kanosej vazhdimisht Partisë dhe shtetit socialist.

Udhëheqja e Partisë e vlerësonte luftën kundër burokratizmit si një nga drejtimet e rëndësishme të luftës klasore dhe theksonte që kjo luftë të zhvillohej «ashtu si edhe kundër armikut të klasës». Kundër shfaqjeve të burokratizmit ajo vendosi të merreshin «masa të rrepta revolucionare», të ndërmerrej «një operacion i thellë, i ndjeshëm dhe i fortë»¹.

Thelbin e kësaj lufte e përbënte përsosja dhe forcimi i gjithanshëm i punës së gjallë ideopolitike, sqaruese, bindëse, organizuese, mobilizuese me njerëzit, tërheqja e masave të gjera në çështjet e qeverisjes së vendit dhe në drejtimin e ekonomisë.

Komiteti Qendror i Partisë udhëzonte që gjithë punonjësit, në radhë të parë komunistët, të bëheshin plotësisht të ndërgjegjshëm për rrezikun që paraqiste burokratizmi dhe për domosdoshmërinë e një lufte të pamëshirshme e sistematike kundër tij. Partia duhej t'i edukonte e t'i mësonte ata të tre-

1 Vendim i Byrosë Politike të KQ të PPSH, 24 dhjetor 1965. Dokumentë kryesorë të PPSH, vëll. IV, f. 603-604.

goheshin të papajtueshëm me çdo shtrembërim burokratik, të godisnin me forcë zvarritjet, sorollatjet burokratike, familjaritetin dhe miqësitë e sëmura, hatëret, shpërdorimin e pozitës zyrtare, përtacinë, kapadaillëkun, mendjemadhësinë, qëndrimet arrogante e të pavëmendshme ndaj punonjësve, mbytjen e zërit të masave.

Organet e larta të Partisë e të shtetit ngarkoheshin të zhduknin çdo lloj tutele burokratike mbi organet më të ulëta.

Komitetet e partisë në rrethe dhe organizatat-bazë duhej jo vetëm të zbatonin udhëzimet nga lart por edhe të vetëvepronin nga pozitat e politikës proletare të Partisë, duke mbajtur përgjegjësi të plotë për kryerjen e detyrave të besuara; këshillat popullore me organet e tyre ekzekutive të përdornin të gjitha kompetencat e të drejtat, të vendosura me ligj.

Vendimet, rregulloret, evidencat, statistikat, shkresat janë gjithnjë të nevojshme, por, kur ato e kalojnë masën, bëhen të dëmshme, pengojnë zgjidhjen e drejtë të detyrave e të problemeve. Prandaj çdo gjë e tepërt duhej të braktisej.

Komiteti Qendror e shikonte gjithashtu të domosdoshme të bëhej një shpërndarje më e drejtë e komunistëve dhe e kuadrove, duke forcuar prodhimin e bazën me kuadro të kualifikuar dhe duke shkurtuar e thjeshtuar organikat e aparateve e të administratës në përgjithësi.

Me sy kritik do të shikoheshin edhe gjithë ligjet e dekretet shtetërore në përputhje me stadin e ri të zhvillimit të shoqërisë socialiste. Udhëheqja e Partisë vinte detyrë që ato të ripunoheshin me pjesëmarrjen e gjerë të masave, duke i zhveshur nga nenët e panevojshme dhe të vjetëruara, nga formulimet e ngatërruara për t'i bërë ato sa më të thjeshta e më të kuptueshme, sa më edukuese.

Një rol të madh në revolucionarizimin e mëtejshëm të jetës së vendit luajtën **vendimet e Komitetit Qendror të Partisë për rregullimin e përpjesëtimit midis pagave të larta dhe pagave të mesme e të ulëta, për krijimin e komiteteve të partisë në ushtri, për rivendosjen e komisarëve politikë dhe për heqjen e gradave ushtarake.**

Rregullimi i përpjesëtimit në shpërblimin e punës prekte vetëm pagat e larta të një numri punonjësish të aparatit shtetëror e të partisë, të shkencës e të kulturës, pa ndryshuar pagat e ulëta e të mesme. Dallimi ndërmjet pagave të larta dhe të

ulëta në Shqipërinë socialiste nuk ka qenë asnjëherë shumë i theksuar. Megjithatë, Partia e quajti të domosdoshme që përpjesëtimi ndërmjet pagave të larta e të ulëta të zvogëlohej edhe më. Kjo masë diktohej nga nevoja për të afruar sa më shumë nivelin e jetesës së kuadrove drejtues dhe të punonjësve të kategorisë së lartë të kulturës e të shkencës me nivelin e jetesës së gjithë punonjësve të vendit. Me anën e kësaj mase u pritej rruga prirjeve që mbivlerësojnë punën e zyrave, që nxitin jetën e rehatshme e fitimin, që krijojnë truall për shthurje mikroborgjeze e për përhapjen e pikëpamjeve revizioniste. Njëkohësisht Partia pati kujdes të mos kalohej në barazimtarizëm. Puna drejtuese dhe e kualifikuar do të çmohej edhe në të ardhmen, por gjithnjë në përshtatje me parimin dhe direktivën e Partisë për të mos lejuar krijimin e shtresave të privileguara.

Krijimi i komiteteve të partisë, rivendosja e komisarëve politikë dhe heqja e gradave në ushtri kishin qëllim të ruhej e të forcohej më tej karakteri revolucionar popullor i Forcave të Armatosura të Republikës dhe të ngrihej në një shkallë më të lartë udhëheqja e Partisë në ushtri.

Gradat dhe komandat e njësuara, me gjithë të mirat që patën sjellë në kohën e vet për t'i dhënë Ushtrisë Nacionalçlirimtare, të dalë nga lufta partizane, karakterin e një ushtrie moderne, në kushtet e reja qenë bërë pengesë për zbatimin e vijës revolucionare të Partisë në ushtri. Ato pengonin vendosjen e marrëdhënieve të ngushta midis kuadrove drejtues dhe ushtarëve, frenonin zhvillimin e iniciativës krijuese, ushqenin mendjemadhësinë e fodullëkun, prepotencën, arrogancën e vese të tjera borgjeze, përmbanin, pra, rrezikun e shkëputjes së oficerëve dhe të gjeneralëve nga populli.

Vendimet e reja të Komitetit Qendror për ushtrinë e mënjanonin këtë rrezik, çelnin rrugën për ngritjen e mëtejshme të përgatitjes ideopolitike, të aftësisë ushtarake dhe të gatishmërisë luftarake të Forcave të Armatosura, për rritjen e fuqisë mbrojtëse të atdheut.

Komiteti Qendror përqendroi gjithë vëmendjen që vendimet të kuptoheshin drejt e thellë nga Partia e nga populli, të zbatoheshin me bindje të plotë për domosdoshmërinë e për karakterin e tyre revolucionar dhe të shkatërrohej çdo spekulim, që mund të bënte armiku, për t'i paraqitur këto vendime

si një ndryshim vije të Partisë ose si një kopjim të ndonjë praktike të huaj.

Nga punimi i vendimeve revolucionarizuese të Komitetit Qendror në organizatat e Partisë, shoku Enver Hoxha nxori konkluzione shumë të rëndësishme, që ndihmonin për të çuar deri në fund zbatimin e këtyre vendimeve.

Praktika kishte treguar, vërejtja ai, se vija e Partisë kishte genë dhe vazhdonte të ishte e drejtë, se kryesorja ishte bilanci pozitiv, por në veprimtarinë praktike të Partisë e të pushtetit kishte edhe gabime e shtrembërime. «Përpara këtyre të metave ne duhet të qëndrojmë si marksistë, t'i shohim këto në sy, pa frikë, t'i analizojmë, t'i kritikojmë e t'i ndreqim pa atë «turpin» mikroborgjez»¹.

Partia kërkonte që vendimet dhe masat për luftën kundër burokratizmit të vlerësoheshin drejt nga pikëpamja ideologjike e politike e të mos merreshin si masa thjesht administrative që kishin të bënin vetëm me pakësim shkresash dhe shkurtrim organikash. Po të mos vlerësoheshin kështu, paralajmëronte shoku Enver Hoxha, pavarësisht nga vendimet, shkresat përsëri do të shtoheshin, organikat prapë do të fryheshin. **Çështja kryesore e kësaj lufte është që pushteti politik të qëndrojë kurdoherë një pushtet popullor, një pushtet proletar, të mos shndërrohet kurrë në pushtet burokratik borgjezo-revizionist.**

Garanci për zbatimin e vendimeve për revolucionarizimin e mëtejshëm të jetës së vendit, si për çdo vendim e direktivë tjetër të Partisë dhe si çdo herë tjetër, do të ishte mbështetja e popullit. Prandaj shoku Enver Hoxha e gjykonte të nevojshme se, duke i bërë të qartë komunistët e popullin për domosdoshmërinë e masave të reja në stadin e ri të revolucionit, Komiteti Qendror të dilte me këtë rast përpara tyre me autokritikë. Njëkohësisht Partia lypsej të zhvillonte një punë të gjallë e të shkathët për sqarimin ideologjikisht të problemeve-kyç që përmbanin vendimet.

«Unë kam bindjen, — arrinte në përfundim shoku Enver Hoxha, — se çdo gjë do të kalojë mirë, sepse ne kemi një parti të çeliktë marksiste-leniniste, revolucionare...»²

1 Enver Hoxha. Fjala në Byronë Politike, shkurt 1966. Raporte e fjalime 1965-1966, f. 208-209.

2 Po aty, f. 245.

Më 4 mars 1966 Plenumi i Komitetit Qendror të Partisë vendosi t'u drejtohej me një **letër të hapur** komunistëve, punonjësve, ushtarëve dhe oficerëve, me anën e së cilës u raportonte atyre për vendimet revolucionarizuese që kishte marrë muajt e fundit dhe u bënte thirrje të luftonin me të gjitha forcat për të zbatuar detyrat që rridhnin nga këto vendime.

Në letër bëhej përgjithësimi marksist-leninist i veprimtarisë dhe i përvojës së Partisë në vitet e fundit, vite të një pune dhe lufte të dendur revolucionare. Krahas sukseseve dhe fitoreve, Partia i fliste popullit hapur edhe për të metat e gabimet e saj.

Për të plotësuar me nder detyrat që dilnin përpara, Komiteti Qendror kërkonte të zbatohet me vazhdimësi dhe me këmbëngulje vija e masave në të gjitha fushat e jetës, në tërë veprimtarinë e Partisë e të pushtetit popullor. Si kurdoherë, edhe zgjidhjen e detyrave të ardhshme Partia do ta gjente te populli.

Për këtë arsye, theksonte letra, «çdo komunist e çdo punonjës të punojë e të mendojë si revolucionar çdo ditë e çdo orë, në çdo punë që kryen apo në çdo funksion që zë, ta ndiejë veten kurdoherë shërbëtor të devotshëm të popullit, të lidhur me punëtorin, fshatarin apo ushtarin për jetë e vdekje, i gatshëm gjithnjë që, në emër të popullit, të atdheut, të revolucionit, të komunizmit, të sakrifikojë edhe jetën e vet... Kjo ka rëndësi jo vetëm për të sotmen, por edhe për të ardhmen e atdheut tonë socialist...». «Populli është mbi të gjitha. Ky është parimi bazë që i ka udhëhequr dhe i udhëheq në gjithë veprimtarinë e tyre Partinë dhe organet e pushtetit popullor»¹.

Komiteti Qendror shprehte bindjen se masat që kishte marrë dhe do të merrte Partia për revolucionarizimin e mëtejshëm të vendit do të kuptoheshin drejt nga të gjithë si masa për zhvillimin e pandërprerë të revolucionit, për forcimin e gjithanshëm të shoqërisë socialiste, për ta bërë të pa thyeshme mbrojtjen e atdheut. Këto masa shkatërronin truallin e veprimtarisë së armiqve të klasës, u prishnin atyre planet për përmbysjen e rendit socialist dhe rivendosjen e kapitalizmit.

1 Letër e hapur e KQ të PPSH, 4 mars 1966. Dokumente kryesore të PPSH, vëll. V, f. 24, 30.

Letra e hapur e Komitetit Qendror u bë një armë e shëndoshë në duart e komunistëve dhe të gjithë punonjësve. Ajo ngjalli një entuziazëm të lartë revolucionar në mbarë vendin.

Krahas një pune të gjerë ideopolitike edukuese, me pjesëmarrjen e masave punonjëse, brenda një kohe të shkurtër, u përsos organizimi mbi baza më të shëndosha revolucionare i aparatit të shtetit dhe të Partisë në qendër e në rrethe. U përmirësua gjithashtu organizimi i administratave të ndërmarrjeve shtetërore e të kooperativave bujqësore. Thirrjes së Partisë për të punuar në frontin kryesor, në prodhim, iu përgjigjën në masë kuadrot drejtues dhe punonjësit e tjerë të administratës. Partia e përkrahu këtë iniciativë revolucionare si një shfaqje të patriotizmit socialist. Rreth 15 mijë kuadro të administratës kaluan në prodhim, sidomos në fshat. Një numër i mirë kuadros, ndërmjet tyre edhe kuadro të lartë të Partisë e të shtetit, u dërguan nga qendra në bazë. Personeli i administratës shtetërore në qendër u përgjysmua. Thjeshtimi i aparatit administrativ u shoqërua me shkurtimin e korrespondencës, duke zgjeruar e thëlluar kështu punën e gjallë me njerëzit. Thjeshtësime u bënë gjithashtu në sistemin e planifikimit, të evidencave, të kontabilitetit etj.

U gjallërua puna në lëmin ekonomik. Prodhime më të larta se çdo vit tjetër u morën në pjesën më të madhe të bimëve bujqësore, sidomos në drithërat e bukës. Shumë kooperativa bujqësore malore për herë të parë, më 1966, prodhuan vetë gjithë bukën e vitit. Edhe plani i prodhimit industrial për vitin 1966 u tejkalua.

Filloi një lëvizje e madhe për të lidhur punën mendore me punën fizike, me prodhimin. Punonjës të punës mendore në masë shkuan vullnetarisht për të ndihmuar fshatarësinë në punimet bujqësore. Me vendim të Komitetit Qendror u bë riorganizimi mbi baza më të shëndosha i punës drejtpërdrejt në prodhim për njerëzit e punës mendore; të gjithë nëpunësit e punonjësit e shkencës e të kulturës filluan të punonin në prodhim një muaj çdo vit. Veç kësaj, dhjetëra mijë të rinj të shkollave të mesme e të larta morën pjesë në aksione vullnetare ndërtimi dhe prodhimi.

Gjallëri të veçantë mori përgatitja ushtarake e fizike e popullsisë. Çështja e mbrojtjes po kuptohej gjithnjë më mirë nga masat si një çështje jetësore për fatet e pavarësisë e të socializmit në Shqipëri. Karakteri popullor revolucionar i ush-

trisë u thellua më tej. Ky thellim u shpreh sidomos në forci-
min e lidhjeve të ushtrisë me popullin.

Kështu iu dha një grusht i rëndë burokratizmit dhe u
shënua një kthesë në mënyrën e të menduarit, të jetuarit dhe
të vepruarit të punonjësve si revolucionarë.

Por Partia nuk i quante masat që mori në vitin 1966 për
revolucionarizimin e mëtejshëm të saj e të jetës së vendit si
hapa të fundit, por si hallka të një procesi të gjatë revolucionar
që duhej të shkonte pa pushim në ngjijtje.

Kongresi V i PPSH, që zhvilloi punimet e veta në Tiranë
prej 1 deri më 8 nëntor 1966, do t'i jepte një shtytje të më-
tejshme këtij procesi.

Në Kongres morën pjesë 791 delegatë me votë deliberative
dhe 43 delegatë me votë konsultative, që përfaqësonin 63 013
anëtarë dhe 3 314 kandidatë për anëtarë partie.

Kongresi analizoi veprimtarinë e Partisë në kushtet e bllo-
kadës imperialisto-revizioniste dhe përcaktoi detyrat **për thel-
llimin e pandalshëm të revolucionarizimit të saj e të gjithë jetës
së vendit**, të ndërthurur me luftën kundër imperializmit e re-
vizionizmit në shkallë ndërkombëtare. Ai bëri disa ndryshime
në Statutin e Partisë dhe miratoi direktivat e planit të 4-t pe-
sëvjeçar.

Thellimi i revolucionit ideologjik [^] Vendimet dhe masat e
në kuadrin e zhvillimit Partisë për revolucio-
të revolucionit socialist narizimin e mëtejshëm
në të gjitha fushat të saj dhe të mbarë je-

tës së vendit ishin të li-
dhura në radhë të parë me thellimin e revolucionit ideologjik.

Revolucionin ideologjik Partia e kishte parë dhe e shi-
konte gjithnjë si pjesë përbërëse organike të revolucionit so-
cialist në përgjithësi.

Përvoja e revolucionit socialist jo vetëm në Shqipëri, por
edhe në vendet e tjera kishte vërtetuar tashmë plotësisht tezën
e Marksit e të Leninit se ky revolucion nuk merr fund as me
fitoren në lëmin politik, domethënë me vendosjen e pushtetit
proletar, as me fitoren në lëmin ekonomik, domethënë me ndër-
timin e bazës ekonomike të socializmit në qytet e në fshat. Për-
derisa nuk është siguruar fitorja e plotë e revolucionit socialist

në fushën e ideologjisë e të kulturës/— vinte në dukje Kongresi V, — nuk mund të jenë të sigurtat e të garantuara as fitoret e revolucionit socialist në fushën politike dhe ekonomike»¹.

qelimi
Siç e përcaktoi Kongresi, qëllimi themelor i revolucionit ideologjik «është rrënjësja dhe triumfi i plotë i ideologjisë socialiste proletare në ndërgjegjen e gjithë popullit punonjës dhe çrrënjësja nga rrënjët e ideologjisë borgjeze, është edukimi dhe kalitja e gjithanshme revolucionare e komuniste e njeriut të ri, që përbën faktorin vendimtar për zgjidhjen e të gjitha problemeve të mëdha e të ndërlikuara të ndërtimit socialist dhe për mbrojtjen e atdheut»².

Por revolucioni nuk zhvillohej vetëm në fushën ideologjike. Ai zhvillohej edhe në fushën politike për ruajtjen, për forcimin dhe për përsosjen e diktaturës së proletariatit; edhe në fushën ekonomike për ruajtjen, për forcimin e për përsosjen e marrëdhënieve socialiste në prodhim e për ndërtimin e plotë të bazës materialo-teknike të socializmit, gjithnjë si një proces i vetëm, i pandarë revolucionar politik, ekonomik, ideologjik e kulturor.

Revolucioni ideologjik në Shqipëri, si pjesë organike e revolucionit në përgjithësi, filloi kur nisi, nën udhëheqjen e Partisë, revolucionin politik (në periudhën e Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare). Me vendosjen e diktaturës së proletariatit, kur klasa punëtore ushtronte tashmë sundimin e vet politik, ideologji sunduese në vend u bë ideologjia proletare, marksizëm-leninizmi, por kjo nuk do të thotë se u bë ideologjia e vetme në vend. Ideologjia e vjetër, borgjeze, feudale e patriarkale, në ndërgjegjen e masave popullore nuk qe shkatërruar, ajo vazhdonte të kishte rrënjë të thella. Në kushtet e diktaturës së proletariatit, revolucioni ideologjik mori një zhvillim shumë të gjerë. Ndërtimi i bazës ekonomike të socializmit në qytet e në fshat përbente një fitore historike në lëmin ekonomik-shoqëror, por edhe një fitore të madhe politike e ideologjike. Me arritjen e kësaj fitoreje, revolucioni ideologjik hyri në një etapë të re, më të lartë të luftës me ideologjinë borgjeze, për fitoren e tij të plotë, që do të shënojë njëkohësisht edhe fitoren e plotë të revolucionit socialist në përgjithësi.

1 Enver Hoxha. Raport mbi veprimtarinë e KQ të PPSH, mbajtur në Kongresin V të PPSH. Dokumente kryesore të PPSH, vëll. V, f. 151.

2 Dokumente kryesore të PPSH, vëll. V, f. 150.

Kongresi V e vlerësoi kështu rëndësinë e revolucionit ideologjik: «Lufta në frontin ideologjik, për shpartallimin e plotë të ideologjisë borgjeze e revizioniste, në fund të fundit, ka të bëjë me çështjen a do të ndërtohet socializmi e komunizmi dhe do të mënjanohet restaurimi i kapitalizmit, apo do t'i çelet porta përhapjes së ideologjisë borgjeze e revizioniste dhe do të lejohet kthimi prapa drejt kapitalizmit»¹.

Kongresi theksoi gjithashtu se lufta në frontin ideologjik është pjesë e luftës së përgjithshme klasore për ta çuar deri në fund revolucionin socialist në të gjitha fushat. Vetëm duke e kuptuar dhe duke e zhvilluar drejt nga pozita marksiste-leniniste luftën e klasave në përgjithësi, mund të kuptohet e të zhvillohet drejt edhe lufta në frontin ideologjik, revolucionin ideologjik.

Revizionistët modernë, duke ndjekur politikën e pajtimit me armiqtë e klasës, të brendshëm e të jashtëm, përpiqeshin të vërtetonin gjoja se në kushtet aktuale të zhvillimit botëror mësimet e Marksit e të Leninit mbi luftën e klasave qenë vjetruar! Ata e paraqisnin veçanërisht të kapërcyer luftën e klasave në socializëm. Sulmonin me ashpërsi Stalinin, që kishte mbrojtur e kishte pasuruar teorinë marksiste-leniniste të luftës së klasave dhe që e kishte zbatuar me besnikëri në kushtet e Bashkimit Sovjetik.

Ndërkaq, edhe udhëheqja kineze propagandonte pikëpamje të kundërta me teorinë marksiste-leniniste të luftës së klasave. Krahas teorisë «Le të lulëzojnë njëqind lule, le të konkurrojnë njëqind shkolla», që përbën një mohim të hapur të luftës së klasave, ajo mbronte tezën se borgjezia, si klase, nuk zhduket me ndërtimin e bazës ekonomike të socializmit, por vazhdon të ekzistojë, krahas klasës punëtore, për gjithë periudhën e kalimit nga kapitalizmi në komunizëm! Me anë të kësaj teze, udhëheqësit kinezë mundoheshin të përligjinin ruajtjen të paprekur të klasës kapitaliste në «shoqërinë socialiste» kineze, që, siç u bë e qartë më vonë, s'ishte aspak socialiste.

Këtë tezë antimarksiste ata u përpoqën t'ia impononin Partisë së Punës të Shqipërisë në maj 1966 gjatë bisedimeve në Pekin midis një delegacioni të saj, të kryesuar nga shoku Mehmet Shehu, dhe palës kineze, të kryesuar nga Çu En Lai. Ky i fundit kërkoi me këmbëngulje që pikëpamja e pranisë

¹ Dokumente kryesore të PPSH, vëll. V, f. 151.

së klasës kapitaliste në Shqipëri (!), ashtu si në Kinë, të futej në deklaratën e përbashkët shqiptaro-kineze dhe shkoi aq larg sa të vinte edhe si kusht pranimin e kësaj kërkese për nënshkrimin e deklaratës. Por përfaqësuesit e PPSH nuk u epën përpara presionit. Ata mbrojtën me vendosmëri pikëpamjet marksiste-leniniste mbi klasat dhe luftën e klasave.

Një muaj më vonë, Çu En Lai erdhi vetë në Tiranë, ku shtroi përsëri përpara udhëheqjes së PPSH tezën e Mao Ce Dunit mbi ekzistencën e borgjezisë, si klasë, gjatë gjithë periudhës së ndërtimit socialist, duke u munduar të vërtetonte «drejtësinë» e tezës kineze dhe «gabimet» e Stalinit mbi luftën e klasave! Shoku Enver Hoxha ia rrëzoi atij me argumente shkencore të gjitha arsyetimet sofistike, duke mbrojtur pikëpamjet e drejta marksiste-leniniste të PPSH për këtë çështje, të shprehura në Kongresin IV të saj, ku u shpall se ishte ndër-tuar baza ekonomike e socializmit si në qytet ashtu edhe në fshat. Me arritjen e kësaj fitoreje historike në zhvillimin e revolucionit socialist, klasat shfrytëzuese qenë zhdukur si klasë.

Duke u nisur nga rëndësia e madhe që kishte kuptimi i drejtë dhe zbatimi revolucionar i teorisë marksiste-leniniste mbi luftën e klasave për ndërtimin e plotë të shoqërisë socialiste, Kongresi e quajti të nevojshme të sqaronte mirë qëndrimin e Partisë në lidhje me luftën e klasave në socializëm. «Partia, — theksoi Kongresi, — mendon se lufta e klasave, edhe pas likuidimit të klasave shfrytëzuese, mbetet një nga forcat kryesore lëvizëse të shoqërisë... Kjo luftë në socializëm, siç tregojnë edhe eksperiencat e vendit tonë, është një fenomen objektiv dhe i pashmangshëm»¹. Lufta e klasave brenda vendit jo vetëm nuk ndërpritet e nuk shuhet, por edhe zhvillohet ashpër, valë-valë e gërshetohet me luftën e klasave në frontin e jashtëm. Ajo përfshin të gjitha fushat e jetës.

Lufta klasore zhvillohet kundër armiqve të brendshëm e të jashtëm. Zhvillohet kundër mbeturinave të klasave shfrytëzuese, që vazhdojnë të bëjnë qëndresë dhe presione me të gjitha mënyrat mbi punonjësit. Zhvillohet edhe kundër elementëve të rinj borgjezë e të degjeneruar, që linden në gjirin e shoqërisë socialiste. Ajo zhvillohet gjithashtu kundër shfaqjeve e shtrembërimeve burokratike, kundër qëndrimeve liberale e konservatore. Zhvillohet kundër vjedhjeve e kundër shpër-

¹ Dokumente kryesore të PPSH, vëll. V, f. 151-152 (nënvizim i Red.)

dorimeve të pasurisë socialiste, kundër gjithfarëloj shfaqjesh të huaja, konceptesh, shprehish e zakonesh të vjetra me përmajtje patriarkale, feudale e borgjeze, kundër psikologjisë mikroborgjeze dhe paragjykimeve fetare. Ajo zhvillohet kundër ideologjisë borgjeze e revizioniste, kundër presioneve e ndikimeve politike dhe ideologjike të imperializmit e të revizionizmit, që bëhen burim qëndrimesh e mendimesh të huaja, reaksionare, regresive në punë, në shoqëri, në mënyrën e jetesës, në shkencë, në art e në letërsi.

Lufta e klasave, vuri në dukje Kongresi, pasqyrohet edhe brenda në Parti, ndonëse kjo është një parti monolite e klasës punëtore. Komunistët nuk janë të zhveshur plotësisht ose të paprekshëm nga konceptet, zakonet e shprehitë e vjetra që bart rrethi shoqëror ku kanë jetuar e jetojnë. Ata nuk janë të paprekshëm as nga ndikimet e ideologjisë borgjeze e revizioniste nga jashtë. Si rrjedhim, edhe nga radhët e Partisë mund të dalin dhe dalin njerëz që degjenerojnë, që kalojnë edhe në pozita armiqësore, antiparti dhe antisocialiste. Armiqtë madje kanë një pikësynim të veçantë të prishin e të bëjnë me vete sidomos kuadro komunistë në organet udhëheqëse të Partisë e të pushtetit, që të mund t'i çelin rrugë të gjerë realizimit të qëllimeve të tyre për asgjësimin e rendit socialist me anë të agresionit të armatosur ose me anë të kundërrevolucionit paqësor. Prandaj është e domosdoshme të zhvillohet një luftë sistematike klasore edhe në Parti, e çila drejtohet kundër elementëve antiparti, kundër shmangieve, nga ideologjia dhe vija politike proletare e Partisë, shtrembërimeve dhe shkeljeve të vendimeve e të direktivave të saj; kundër thyerjeve të parimeve e normave të Statutit; kundër të metave e gabimeve në punën e organeve udhëheqëse e të organizatave-bazë të partisë, kundër oportunitizmit, sektarizmit, dogmatizmit e gjithfarë pikëpamjesh të huaja antimarksiste.

Për të gjitha këto arsye, Kongresi V theksoi me forcë se «çdo largim nga lufta e klasave është me pasoja vdekjeprurëse për fatet e socializmit», se duke e zhvilluar këtë luftë kundër armiqve të jashtëm — imperialistëve e revizionistëve, të mos lihet kurrë pas dore, të mos harrohet kurrë lufta e klasave brenda vendit. «Ndryshe historia do të na ndëshkonte rëndë»¹.

Kongresi e cilësoi pranimin ose mospranimin e luftës së

1 Dokumente kryesore të PPSH, vëll. V, f. 152.

klasave në socializëm një vijë demarkacioni midis marksistë-leninistëve dhe revizionistëve, midis revolucionarëve dhe tradhtarëve të revolucionit.

Në rrethanat konkrete të sulmit frontal që kishte filluar Partia për revolucionarizimin e saj e të jetës së vendit, duke theksuar nevojën për ta zhvilluar luftën e klasave «për ditë e në çdo fushë të jetës», ai kapi si hallkë kryesore luftën **ideologjike** për ta çuar përpara revolucionin në të gjitha fushat.

Zgjidhja e detyrave të mëdha e të vështira të ndërtimit të plotë të shoqërisë socialiste, lufta e ashpër klasore në shkallë kombëtare e ndërkombëtare lypin medoemos njerëz me ndërgjegje të lartë socialiste, të çliruar nga konceptet e zakonet patriarkale, feudale e borgjeze si edhe nga paragjykimet fetare, të brumosur me ideologjinë proletare, me një kalitje dhe vendosmëri të madhe revolucionare.

Revolucioni ideologjik shërbente si armë e fuqishme në duart e Partisë e të klasës punëtore, për revolucionarizimin e gjithë superstrukturës së shoqërisë. Ai çlironte diktaturën e proletariatit, gjithë institucionet politike, ekonomike e shoqërore nga mjaft dispozita juridike, forma e metoda të përshtatshme për etapën e parë të ndërtimit socialist të vendit, por tashmë të vjetruara e të shndërruara në një pengesë për ecjen me vrull përpara. Ai spastronte superstrukturën nga çdo gjë e huaj që kishte depërtuar në të dhe ndriçonte rrugën për të gjetur e për të zbatuar forma e metoda të reja më revolucionare, që të realizohej më mirë udhëheqja e klasës punëtore dhe pjesëmarrja e drejtpërdrejtë e gjithë masave punonjëse në qeverisjen e vendit e në drejtimin e ekonomisë, të forcohej diktatura e proletariatit.

Në kuadrin e luftës politike e ideologjike për forcimin e diktaturës së proletariatit, Kongresi vuri detyrë të vazhdohej puna dhe lufta për forcimin dhe për përsosjen e vazhdueshme të Ushtrisë Popullore, të organeve të Punëve të Brendshme, të të gjitha Forcave të Armatosura të Republikës, duke pasur si pikësynim kryesor lidhjen gjithnjë e më të ngushtë të tyre me popullin, kalitjen e mëtejshme revolucionare, përgatitjen sistematike politike, ideologjike dhe ushtarake për të qenë kurdoherë të afta e të gatshme të mbrojnë fitoret e revolucionit, atdheun socialist. Njëkohësisht u theksua nevoja e përsosjes së punës për përgatitjen ushtarake dhe për rritjen e gatishmërisë luftarake të mbarë popullit.

Thellimi i revolucionit ideologjik ngrinte në një shkallë më të lartë rolin shndërrues të ideve revolucionare marksiste-leniniste në zhvillimin e gjithë shoqërisë. Ideologjia proletare e përvetësuar nga masat e gjëra të punonjësve ndikon fuqimisht në përsosjen e marrëdhënieve socialiste në prodhim, të bazës ekonomike të shoqërisë, në ruajtjen, në zgjerimin e në forcimin e pronës socialiste, në thellimin e karakterit socialist të shpërndarjes, në revolucionarizimin e vazhdueshëm të drejtimit të ekonomisë, si edhe në zhvillimin e forcave prodhuese e të revolucionit tekniko-shkencor.

Një objektiv i rëndësishëm i revolucionit ideologjik, në të cilin Kongresi u ndal në mënyrë të posaçme, ishte çështja e çlirimit të plotë të gruas, mbi bazën e përparimeve të mëdha që ishin arritur deri atëherë në këtë fushë. Ai e quajti këtë çështje «një nga problemet më të rëndësishme të ndërtimit socialist, një çështje të madhe politike, ideologjike e shoqërore»¹.

Revolucioni ideologjik do të zhvillohej nën parullën «Të mendojmë, të punojmë dhe të jetojmë si revolucionarë»², parullë që do të përbënte thelbin e edukimit komunist, përmbajtjen themelore të të gjithë punës edukuese të Partisë.

Edukimit komunist të punonjësve, thellimit të revolucionit ideologjik ishte e domosdoshme t'i përgjigjej zhvillimi i një pune më të organizuar e më të përsosur për studimin dhe përvetësimin e teorisë marksiste-leniniste nga komunistët, nga kuadrot, nga klasa punëtore dhe gjithë punonjësit. Për këtë qëllim, udhëzonte Kongresi, «duhet një luftë e ashpër kundër konceptit intelektualist borgjez dhe reaksionar se teoria, filozofia, shkenca e arti janë të vështira dhe nuk mund të kapen nga masat, se ato mund të kuptohen vetëm nga kuadrot dhe nga inteligjencia... Marksizëm-leninizmi nuk është një privilegj e monopol i disa njerëzve që «kanë kokë» për ta kuptuar atë. Ai është ideologjia shkencore e klasës punëtore dhe e masave punonjëse dhe vetëm atëhere kur idetë e tij bëhen të masave të gjëra punonjëse, ai nuk mbetet diçka abstrakte, por shndërron në një forcë të madhe materiale për transformimin revolucionar të botës»³.

1 Dokumente kryesore të PPSH, vëll. V, f. 142.

2 Po aty, f. 159 (nënvizimi i Red.).

3 Po aty, f. 169.

Revolucionit ideologjik i shërbente drejtpërdrejt **revolucioni në fushën e kulturës** që zhvillohet në unitet dhe në lidhje organike me të. «Gjithë puna kulturore, arsimore, artistike duhet të na vlejë, në radhë të parë, për të realizuar qëllimin themelor, edukimin e komunistëve e të të gjithë punonjësve me një frymë të lartë klasore revolucionare marksiste-leniniste»¹. Kongresi vuri si detyrë që arti dhe kultura të mbështeten fort mbi truallin amtar, ta kenë burimin te populli dhe të jenë plotësisht në shërbim të tij. Partia e Punës e Shqipërisë, si kurdoherë, i përmbahej me besnikëri parimit leninist të partishmërisë proletare në art, në letërsi dhe në gjithë jetën shpirtërore të shoqërisë. Kultura dhe arti borgjez dekadent, kozmopolitizmi janë të huaj për socializmin. Nga trashëgimia kulturore e artistike shqiptare njerëzit e kulturës dhe të artit do të merrnin, si edhe më parë, vetëm atë që është përparimtare, patriotike, demokratike. Populli shqiptar gjatë shekujve ka krijuar një thesar të pasur të jetës shpirtërore me një përmbajtje të shëndoshë përparimtare, që përbën një truall dhe një burim të madh për artin, letërsinë e në përgjithësi për kulturën e re socialiste. Kongresi vuri në dukje se arti e kultura në Shqipërinë socialiste kanë përfituar e do të përfitojnë edhe nga përvoja e artit dhe e kulturës përparimtare botërore. Por kurrë kultura e re shqiptare nuk do të bëhet skllave e kulturës së huaj dhe nuk do të marrë asgjë pa një analizë të thellë, pa një vlerësim kritik me sy klasor.

Revolucionarizimi i mëtejshëm i shkollës duhej të përfshinte gjithë sistemin arsimor, brendinë dhe metodat e mësimin e të edukimit. Si problem i dorës së parë dilnin kalitja revolucionare politike dhe ideologjike e rinisë, përgatitja më e drejtpërdrejtë e saj për jetën dhe punën, lidhja e mësimin me prodhimin, edukimi i saj komunist nëpërmjet punës.

Revolucionarizimi i mëtejshëm i Partisë dhe cilësitë komuniste të anëtarëve

Forcimin dhe kalitjen e Partisë, si parti revolucionare e klasës punëtore, rritjen e rolit të saj udhëheqës në gjithë jetën e vendit, Kongresi V e quajti kushtin e parë për të zhvilluar pa ndërprerje e për ta çuar deri në fund revolucionin socialist.

¹ Dokumente kryesore të PPSH, vëll. V, f. 159.

PPSH ruante gjithnjë të shëndoshë bazën ideologjike e organizative marksiste-leniniste të saj, pavarësisht se kishte ndonjë organizatë që s'e kryente si duhet rolin udhëheqës, se kishte disa anëtarë partie që i kishin humbur cilësitë e komunistit dhe s'jepnin shembullin e luftëtarit pararojë. «Por ne, — theksonte Kongresi, — për asnjë çast dhe në asnjë drejtim nuk duhet të lejojmë që të çarmatoset Partia, që ajo të dehet nga sukseset, të plogështohet, që atë ta mbysë pluhuri, rutina e burokratizmi»¹.

Duhej përfituar shumë nga përvoja e hidhur e Bashkimit Sovjetik, ku partinë komuniste e mbuloi dalngadalë burokratizmi, rutina, formalizmi dhe plogështia, që e zhveshën atë nga fryma revolucionare dhe e bënë të paaftë për të ndaluar revizionistët të merrnin fuqinë e ta futnin vendin në rrugën e rivendosjes së kapitalizmit.

Për ta mbrojtur Partinë e Punës të Shqipërisë nga burokratizmi dhe nga sëmundje të tjera, për ta forcuar dhe për ta revolucionarizuar atë pa pushim, Kongresi dha orientime e vuri detyra për përmirësimin e vazhdueshëm të përbërjes proletare e të shtrirjes së forcave të Partisë, për rritjen e rolit udhëheqës të organizatave-bazë, për thellimin e vijës së masave, duke përqendruar vëmendjen te cilësitë revolucionare që duhet të karakterizojnë çdo komunist.

Gjatë 25 vjetëve populli shqiptar e kishte njohur komunistin si njeriun më të ndershëm e më besnik, më të vendosur për çështjen e revolucionit e të socializmit, e kishte parë kurdoherë në ballë, kurdoherë të gatshëm të shkojë atje ku është lufta dhe puna më e vështirë, të paepur përballë armiqve, përpara vështirësive e pengesave. Me anë të shembullit të anëtarëve të saj si luftëtarë pararojë, Partia i kishte fituar zemrën popullit, kishte krijuar, kishte mbajtur dhe mbante gjithnjë lidhje të ngushta me masat e gjera, i kishte mobilizuar dhe i mobilizonte ato në revolucion, në ndërtimin socialist e në mbrojtjen e atdheut.

Pikërisht mbi bazën e kësaj përvoje të pasur të veprimtarisë, të qëndrimeve e të sjelljeve revolucionare të anëtarëve të PPSH, shoku Enver Hoxha formuloi cilësitë dalluese të tyre, të cilat u përgjigjeshin kërkesave të reja të rritjes së rolit udhëheqës të Partisë, rrjedhimisht, zbatimit të detyrave të mëdha

¹ Dokumente kryesore të PPSH, vëll. V, f. 122.

të ndërtimit të plotë të shoqërisë socialiste. Këto cilësi gjetën shprehje në raportin e Komitetit Qendror në Kongres, i cili i mishëroi në Statutin e PPSH.

Thelbin e cilësive komuniste të anëtarëve të PPSH e përbën ideja që ata e tregojnë me vepra besnikërinë ndaj marksizëm-leninizmit dhe Partisë, vendosmërinë për t'u shërbyer popullit, revolucionit, socializmit.

Për komunistin qenia në Parti nuk sjell asnjë privilegj për vete e për familjen e tij, asnjë të drejtë më tepër nga ato që gëzojnë të gjithë shtetasit në Shqipërinë socialiste, sjell vetëm detyra më të rënda, përgjegjësi më të madhe.

Komunisti duhet të vihet në krye të masave e t'i udhëheqë ato, por këtë pozitë nuk ia siguron vetvetiu qenia anëtar partie. Ai arrin të bëhet udhëheqës masash, të fitojë besimin e tyre vetëm duke punuar e duke jetuar tok me masat; duke dëgjuar me vëmendjen më të madhe zërin e tyre e duke mësuar prej tyre; duke qenë i thjeshtë, i drejtë, i ndershëm, i çiltër, i dashur me njerëzit, armik i mendjemadhësisë, i frymës së komandimit dhe i arrogancës; duke qëndruar në ballë të punëve, të kryerjes së detyrave, sado të vështira të jenë ato, pa u kursyer të bëjë çdo sakrificë.

Komunistin e dallojnë disiplina e çeliktë dhe e ndërgjegjshme në zbatimin e parimeve, të normave, të vijës marksiste-leniniste të Partisë, në të njëjtën kohë shpirti krijues në vepërrimtarinë e vet revolucionare, në zbatimin e vendimeve e të direktivave.

Komunisti tregon në çdo kohë e në çdo rast vigjilencë të lartë në mbrojtjen e në zbatimin e vijës së Partisë, zhvillon luftë të papajtueshme kundër çdo shkeljeje e shtrembërimi të saj e të ligjeve të shtetit. Luftën e klasave, brenda e jashtë radhëve të Partisë, e zhvillon pa frikë e me urtësi, në bazë të vijës së Partisë, pa rënë as në oportunizëm as në sektarizëm. Nga njëra anë tregohet i pamëshirshëm ndaj armiqve, nga ana tjetër është shumë i durueshëm ndaj shokëve e njerëzve të popullit që gabojnë, për t'i shpëtuar e për t'i ndrequr ata.

Komunisti tregohet gjithashtu i palodhur për ngritjen e tij të vazhdueshme ideopolitike e kulturore, duke e shikuar këtë si një domosdoshmëri për të qenë kurdoherë një luftëtar pararojë.

Kongresi vuri detyrë që këto cilësi, të mishëruara në shumicën dërrmuese të komunistëve, të bëheshin shprehje për gj-

thë anëtarët e partisë, pa përjashtim. «Pa këtë nuk mund të ruhet e gjallë fryma revolucionare në Parti, — theksonte ai, — pa këtë as mund të flitet për revolucionarizimin e jetës së vendit tonë»¹.

Për të siguruar të tilla cilësi edhe te anëtarët e rinj të Partisë, u vendos që jo vetëm të bëhej një zgjedhje më e kujdeshme e kandidatëve për anëtarë partie, por edhe që stazhi i kandidatit, i cili përbën një kohë prove shumë të rëndësishme, nga një vit që kishte qenë më parë të rritej në 2 dhe 3 vjet, në përshtatje me gjendjen shoqërore, me karakterin e punës dhe me përgatitjen ideopolitike të secilit kandidat.

Për një revolucionarizim të mëtejshëm të jetës së brendshme të Partisë, Kongresi kërkonte të forcohej më shumë kritika e autokritika, duke nxjerrë mësim nga kritika dhe autokritika që bënte Komiteti Qendror ndaj gabimeve e të metave të Partisë në Letrën e tij të hapur të marsit 1966. «Partia jonë, — thoshte shoku Enver Hoxha në raport, — kurrë nuk i ka fshehur gabimet e të metat e saj. Ajo me guxim dhe botërisht i ka zbuluar dhe i ka kritikuar ato. . . Mos vallë kjo gjë e ka lëkundur besimin e popullit të Partia? Mos vallë kjo gjë ka ulur shpirtin luftarak të Partisë, të kuadrove, të punonjësve? Përkundrazi, populli më shumë është lidhur me Partinë, dashuria dhe besimi i tij për Partinë janë dhjetëfishuar. . .»².

- + **Direktivat e planit të 4-t** Edhe direktivat e planit të 4-t pesëvjeçar + pesëvjeçar Kongresi i përpunoi në frymën e revolucionarizimit të mëtejshëm të jetës së vendit.

Detyra kryesore të pesëvjeçarit u përcaktua: **Të shpejtohet ndërtimi i plotë i bazës materialo-teknike të socializmit, duke vazhduar industrializimin socialist e duke rritur prodhimin industrial nëpërmjet përdorimit më të plotë të aftësive prodhuese në shfrytëzim dhe nëpërmjet ndërtimit të veprave të reja, duke përqendruar forcat për një zhvillim më të shpejtë të prodhimit bujqësor, sidomos të prodhimit të drithërave, në radhë të parë nëpërmjet intensifikimit të bujqësisë;**

1 Dokumente kryesore të PPSH, vëll. V, f. 128.

2 Po aty, f. 134.

të ngrihet mirëqenia materiale dhe niveli kulturor i popullit dhe të shtohet fuqia mbrojtëse e atdheut;

të përsosen më tej në rrugë revolucionare marrëdhëniet socialiste në prodhim, të ngushtohet gradualisht dallimi midis qytetit dhe fshatit, midis klasës punëtore e fshatarësisë, midis industrisë e bujqësisë dhe midis punës mendore e punës fizike;

të thellohet revolucioni në fushën e ideologjisë e të kulturës, të forcohet diktatura e proletariatit, uniteti i popullit rreth Partisë, të çohet përpara revolucioni socialist në të gjitha fushat.

Kongresi lidhte kështu organikisht zhvillimin ekonomik e kulturor të vendit me revolucionarizimin e mëtejshëm të tij. Revolucionarizimi ishte një bazë e shëndoshë për plotësimin e detyrave të mëdha të zhvillimit të forcave prodhuese e të përsosjes së marrëdhënieve socialiste në prodhim. Anasjelltas, zhvillimi i këtyre forcave e i këtyre marrëdhënieve socialiste përbënin bazën materiale të domosdoshme të plotësimin të detyrave të revolucionarizimit.

Prodhimi industrial do të rritej 50-54 për qind në krahasim me vitin 1965. Me ritëm më të shpejtë do të zhvillohej sidomos industria kimike, mekanike, e energjisë elektrike, e bakrit, e hekur-nikelit. Për herë të parë do të prodhoheshin në vend metale të petëzuara, plehra azotike dhe fosfatike, lloje të ndryshme letre, llamba elektrike e mjaft artikuj të tjerë. Në pesëvjeçarin e katërt vendi hynte në një fazë të re të industrializimit, në fazën e zhvillimit të industrisë së rëndë përpunuese.

Industrializimi mbetej kështu, si edhe më parë, një ndër detyrat me rëndësi jetësore, «... pa zgjidhjen e së cilës, — vërente Kongresi, — nuk mund të çohet përpara revolucioni socialist në frontin ekonomik»¹. Por në të njëjtën kohë Partia i përmbahej vijës së zhvillimit si të industrisë ashtu edhe të bujqësisë, sepse për të qenë e fortë dhe e pavarur ekonomia popullore duhet të mbështetet në të dy këmbët, në industrinë e në bujqësinë.

Prodhimi bujqësor më 1970 parashikohej të ishte 71-76 për qind më i madh se më 1965. Duke siguruar një ritëm më të shpejtë të rritjes së prodhimit bujqësor në krahasim me prodhimin industrial, Partia synonte zbutjen e shpërpjesëtimit midis bujqësisë dhe industrisë, ngushtimin e dallimeve midis fshatit dhe qytetit.

1 Dokumente kryesore të PPSH, vëll. V, f. 92.

Për shtimin e prodhimit bujqësor u vu theksi te rritja e rendimenteve. Duke ndjekur për këtë rrugën e intensifikimit të bujqësisë, njëkohësisht do të hapeshin toka të reja në një masë dyfish më të madhe se në pesëvjeçarin e tretë. Kongresi ho-dhi parullën: «T'u qepemi kodrave e maleve, t'i zbukurojmë e t'i bëjmë ato pjellore si fushat».

Krahas këtyre detyrave, Kongresi dha direktivë që Partia dhe shteti të ndihmonin për t'u bashkuar në kooperativa të gjitha ekonomitë bujqësore që kishin mbetur pa u kolektivizuar dhe që përfaqësonin rreth 10 për qind të tokës së fshatarësisë.

Për plotësimin e detyrave të pesëvjeçarit të katërt u vendos që investimet kapitale të ishin 34 për qind më shumë se në pesëvjeçarin e tretë, 80 për qind e tyre ishte parashikuar të përdroreshin në sektorët prodhues.

Të ardhurat kombëtare do të rriteshin 45-50 për qind. Nga këto u caktua të përdroreshin 28,2 për qind për akumulim dhe 71,8 për qind për përdorim shoqëror e vetjak. Të ardhurat reale për frymë të punëtorëve dhe të nëpunësve shtoheshin 9-11 për qind, kurse të fshatarësisë 20-25 për qind. Çështja e rritjes së mirëqenies së masave ka qenë gjithnjë një nga elementet më të rëndësishme të politikës revolucionare të Partisë. PPSH e shikon ngritjen e mirëqenies jo për të kënaqur teka mikrobor-gjeze, jo për të siguruar një jetë luksi për shtresa e grupe të veçuara të privilegjuara, por për të plotësuar nevojat ma-teriale, kulturore e shpirtërore të mbarë popullit dhe jo ve-tëm për sot, por edhe për nesër. Plotësimi i këtyre nevojave bëhet në përshtatje me shkallën e përgjithshme të zhvillimit ekonomik të vendit, me kërkesat e riprodhimit të zgjeruar e të mbrojtjes.

Në trajtimin e problemeve ekonomike Kongresi u ndal edhe në çështjen e përsosjes së drejtimit të ekonomisë me plan. Ai dënoi rrugën që ndiqnin vendet revizioniste për zëvendësimin e drejtimit të centralizuar të ekonomisë me decentralizimin anarkik, që i çelte rrugën veprimit të ligjeve të kapitalizmit dhe shndërrimit të plotë të ekonomisë socialiste në ekonomi kapitaliste. Kongresi shprehu vendosmërinë e PPSH për të zbatuar me vazhdimësi drejtimin e centralizuar të ekonomisë në bazë të planit shtetëror, të njësuar e të përgjithshëm. Në të njëjtën kohë tërhoqi vëmendjen që ky drejtim shtetëror i cen-tralizuar të ishte thellësisht demokratik, të bashkërendohej me pjesëmarrjen e organizuar, të gjerë e të drejtpërdrejtë të ma-

save, si edhe me zgjerimin e të drejtave e kompetencave të organeve shtetërore dhe ekonomike në të gjitha hallkat.

Kongresi udhëzoi gjithashtu të përdroreshin më me këmbëngulje e në mënyrë sistematike levat dhe kategoritë ekonomike që rregullojnë veprimtarinë e ndërmarrjeve, si kostoja, fitimi, çmimi etj. Por në përdorimin e tyre organet shtetërore dhe ekonomike do të udhëhiqeshin gjithnjë nga politika proletare e Partisë, nga interesat e përgjithshme të socializmit e të mbrojtjes së atdheut.

Detyrat e planit të 4-t pesëvjeçar, si të çdo pesëvjeçari të mëparshëm, qëndronin mbi themele të shëndosha të politikës revolucionare ekonomike të Partisë. Kjo politikë mbështetej fort në ligjet objektive ekonomike të shoqërisë socialiste, në kushtet konkrete të brendshme e të jashtme, në mundësitë reale të zhvillimit të ekonomisë e të kulturës popullore, në burimet, në mjetet, në forcat e brendshme. Ajo u përgjigjej si nevojave aktuale ashtu edhe të perspektivës së ecjes së vendit përpara, dhe vetëm përpara, në rrugën e socializmit.

Të ngrihet në një shkallë më të lartë lufta kundër imperializmit dhe revizionizmit modern

Kongresi V i bëri një analizë të thellë marksiste-leniniste gjendjes ndërkombëtare. Nga kjo analizë nxori konkluzionin kryesor se lufta pa kompromis kundër imperializmit me imperializmin amerikan në krye dhe kundër revizionizmit modern me revizionizmin sovjetik në krye ishte një detyrë me rëndësi vendimtare për fatet e lirisë dhe të pavarësisë, për fatet e socializmit, në shkallë kombëtare dhe ndërkombëtare.

Një nga tiparet themelore të gjendjes ndërkombëtare ishte kristalizimi i një aleance të re midis imperializmit amerikan dhe imperializmit sovjetik.

Në themel të kësaj aleance qëndronin interesat e përbashkëta dhe qëllimi strategjik i përbashkët për ndarjen e zonave të influencës dhe për vendosjen në botë të sundimit të dy fuqive më të mëdha.

Aleanca sovjeto-amerikane po konkretizohej çdo ditë e më tepër dhe po zhvillohej në të gjitha fushat me traktate e marrëveshje të ndryshme, të hapëta dhe të fshehta.

Por kjo aleancë nuk zhvillohej pa vështirësi dhe pa kontradikta. Këto kontradikta e kishin burimin në synimet hegje-

moniste dhe ekspansioniste si të njërit ashtu edhe të tjetrit. imperializëm, në përpjekjet që bënin për të fituar secili epërsi mbi tjetrin.

Kontradikta të thella kishin imperializmi amerikan e revizionizmi sovjetik edhe me aleatët e tyre: SHBA me Francën, e cila kishte hyrë në rrugën e kundërshtimit të hapur, por edhe me Anglinë, Gjermaninë Perëndimore, Japoninë etj.; Bashkimi Sovjetik me vendet e tjera revizioniste e me partitë revizioniste të Evropës Perëndimore kapitaliste, ku po shtoheshin vazhdimisht prirjet e shkëputjes, fërkimet, përpjekjet për të qenë të lirë e të pavarur nga diktati i Moskës.

Për të shkatërruar të gjitha planet agresive të imperializmit amerikan, të revizionizmit hrushovian e të mbarë reaksionit botëror, për të zhvilluar më me sukses luftën kundër tyre, Kongresi V shtroi si një domosdoshmëri objektive me rëndësi të madhe ndërkombëtare bashkimin e popujve në një front të gjerë antiimperialist botëror.

Që ky front të kishte me të vërtetë karakter antiimperialist ishte plotësisht e arsyeshme të bashkoheshin në të të gjithë ata që mbanin në një mënyrë ose në një tjetër qëndrim antiimperialist, me vepra e jo me fjalë, që luftonin në çfarëdo masë kundër imperializmit. «Revizionistët hrushovianë, — thekson Kongresi, — me tërë politikën dhe veprimtarinë e tyre e kanë vënë veten jashtë frontit antiimperialist. Të futësh në këtë front revizionistët do të thotë të futësh kolonën e pestë, «Kalin e Trojës» dhe ta minosh atë nga brenda»¹. Ky qëndrim revolucionar i PPSH ishte njëkohësisht edhe një përgjigje ndaj qëndrimeve të lëkundshme të udhëheqësve të PKK në këtë çështje, ndaj prirjeve të tyre për t'u bashkuar me revizionistët e ndryshëm, edhe me revizionistët sovjetikë, në një front të vetëm «antiimperialist».

PPSH u shpreh edhe një herë në mënyrë të vendosur në Kongresin e saj V se nuk pranonte asnjë lloj uniteti veprimesh me revizionistët hrushovianë. Po të vepronte ndryshe, ajo s'do të bënte gjë tjetër veçse të tradhtonte popullin e vet, socializmin, marksizëm-leninizmin. Revizionizmi modern me revizionizmin sovjetik në krye përbënte tanimë jo vetëm një rrezik kryesor, por edhe një armik kryesor për lëvizjen komuniste e

1 Dokumente kryesore të PPSH, vëll. V, f. 191.

punëtore ndërkombëtare, për socializmin dhe për lirinë e pa-
varësinë e popujve.

Kongresi kritikoi rreptë mbi baza parimore të gjithë ata
që nuk luftonin vetë revizionizmin, por hijen e tij, që mbyllnin
sytë përpara realitetit, bënë sikur nuk e shikonin tradhtinë e
udhëheqësve revizionistë, kërkonin pajtim e unitet me revizio-
nistët ose mbanin një qëndrim centrist. «Sipas mendimit të
Partisë sonë, sot shtrohet me forcë të madhe në rendin e ditës,
si një problem i mprehtë aktual, jo pajtimi e uniteti me revizio-
nistët, por shkëputja, ndarja definitive me ta»¹.

Kongresi përshëndeti krijimin e një vargu partish të reja
dhe grupesh marksiste-leniniste në vende të ndryshme të bo-
tës. Krijimi i partive të reja dhe i grupeve marksiste-leniniste
ishte rrjedhim i natyrshëm i luftës midis marksizëm-leninizmit
dhe revizionizmit. Dy ideologji e dy vija të kundërta nuk mund
të jetojnë kurrë së bashku në gjirin e një partie marksiste-len-
iniste, në veçanti, dhe në gjirin e lëvizjes komuniste ndërko-
mbëtare, në përgjithësi.

Në Kongres u shpreh gatishmëria e PPSH për të ndihmuar
me të gjitha mundësitë forcat e reja marksiste-leniniste. «Ne e
konsiderojmë këtë si detyrën tonë të lartë internacionaliste,
sepse në rritjen dhe në zhvillimin e këtyre forcave të reja revo-
lucionare ne shohim rrugën e vetme të drejtë të triumfit të
marksizëm-leninizmit e të shkatërrimit të revizionizmit»².

Partitë e grupet e reja marksiste-leniniste varën shpresa
sidomos në mbështetjen e Partisë e të RP të Kinës si «parti e
madhe marksiste-leniniste» dhe si «vend i madh socialist». Në
përgjithësi ato mbetën të zhgënjyera kur panë se nuk gjetën
mbështetjen e menjëhershme që shpresonin. Në të vërtetë,
siç u mësua më vonë, Mao Ce Duni me shokë në fillim nuk e
miratuan krijimin e tyre dhe nuk patën asnjë besim në to. Mi-
rëpo, kur këto parti e grupe të reja, kundër vullnetit të udhë-
heqësve kinezë, u krijuan e po forcoheshin, ata ndërruan tak-
tikë. I vunë vetes synim t'i shfrytëzonin ato për interesat e
ngushta të tyre. Prandaj i njohën të gjitha, parti e grupe, pa
përjashtim një ose më shumë të tilla në një vend, mjafton të
vetëquheshin «marksiste-leniniste», «revolucionare», «gardë e
kuqe» etj., ta shpallnin veten ndjekëse të «maocedunidesë».

1 Dokumente kryesore të PPSH, vëll. V, f. 194.

2 Po aty, f. 186.

Ndërkohë, PPSH mbante një qëndrim të matur, duke u nisur nga veprat e jo nga fjalët e njëjës ose tjetrës parti e grup dhe duke gjykuar nga pikëpamja se çdo vend mund të ketë vetëm një parti të vërtetë marksiste-leniniste.

Për përtëritjen revolucionare dhe për forcimin e komunizmit ndërkombëtar, Kongresi e quajti të domosdoshme dhe të ngutshme vendosjen e lidhjeve e të bashkëpunimit të ngushtë, krijimin e unitetit ideologjik e të veprimit midis partive dhe gjithë forcave marksiste-leniniste të vendeve të ndryshme, mbi bazën e marksizëm-leninizmit dhe të internacionalizmit proletar.

Në fund të punimeve të tij, Kongresi V zgjodhi me vota të njëzëshme Komitetin Qendror të PPSH prej 61 anëtarësh e 36 kandidatësh, si edhe Komisionin Qendror të Kontrollit e të Revizionimit. Sekretar i Parë i KQ të PPSH u rizgjodh shoku Enver Hoxha.

Kongresi ishte shprehje e unitetit monolit, e pjekurisë dhe e vendosmërisë së Partisë për ta çuar revolucionin socialist deri në fund. Mbi bazën e përgjithësimi të përvojës së madhe të luftës revolucionare në pesëvjeçarën e fundit, ai e pasuroi dhe e zhvilloi më tej vijën marksiste-leniniste të Partisë për ndërtimin e plotë të shoqërisë socialiste.

Kongresi shprehu vendosmërinë e PPSH në luftën e pandërprerë kundër imperializmit dhe revizionizmit modern.

Marrja pjesë në Kongresin V të PPSH e përfaqësuesve të partive dhe grupeve të reja revolucionare marksiste-leniniste përbënte një ngjarje të rëndësishme për lëvizjen komuniste ndërkombëtare, e cila kishte hyrë në rrugën e përtëritjes mbi baza marksiste-leniniste.

2. ZBATIMI I DETYRAVE PËR REVOLUCIONARIZIMIN E PARTISË E TË PUSHTETIT DHE PËR FORCIMIN E UNITETIT PARTI-POPULL

Analiza shkencore që u bëri Kongresi V problemeve të mëdha të kohës me karakter kombëtar dhe ndërkombëtar, orientimet që ai dha çelën horizonte të reja në rrugën e ndërtimit të plotë të shoqërisë socialiste.

E tërë Partia me levat e saj u mobilizuan për t'i bërë orientimet dhe detyrat e Kongresit sa më të kuptueshme për

popullin, për t'i vënë ato sa më gjerë e më thellë në jetë. Një rol të veçantë për këtë qëllim luajti fjala e shokut Enver Hoxha «Mbi revolucionarizimin e mëtejshëm të Partisë e të pushtetit», mbajtur më 6 shkurt 1967.

Zbatimi revolucionar i parimeve e i normave të Partisë për forcimin e karakterit proletar të saj

nga burimet kryesore të fitoreve të mëdha të saj. Por në rrethanat e përhapjes së revizionizmit e të luftës së ashpër midis tij dhe marksizëm-leninizmit në shkallë ndërkombëtare, në kushtet e vrullit të ri revolucionar që kishte shpërthyer në Shqipëri, zbatimi i tyre revolucionar merrte një rëndësi të veçantë për ruajtjen e për forcimin e karakterit proletar të Partisë, për zhvillimin e mëtejshëm të revolucionit socialist në të gjitha fushat.

Partia e klasës punëtore s'mund të ketë një vijë të drejtë marksiste-leniniste pa pasur njëkohësisht e pa zbatuar në mënyrë revolucionare parime e norma organizative komuniste. Kur Partia Komuniste e Bashkimit Sovjetik u largua nga ideologjia dhe politika leniniste-staliniane, hoqi dorë edhe nga zbatimi revolucionar i parimeve e i normave marksiste-leniniste të partisë, të cilat u shndërruan në formula të vdekura.

Në fjalën e 6 shkurtit shoku Enver Hoxha kritikoi ndjenjën e vetëkënaqësisë që kishte lindur në disa komunistë e kadro si pasojë e fitoreve dhe që nuk i linte ata të shihnin të metat e gabimet, shkeljet e parimeve e të normave të Statutit. Kjo ndjenjë vetëkënaqësie i kishte rrënjët në konceptin idealist e metafizik, sipas të cilit organet dhe kadrot drejtues të Partisë e të pushtetit janë të pagabueshëm e të pakritikueshëm. Këtej rridhte që në shumë raste kritika dhe autokritika në organizatat e partisë si edhe kritika kundrejt organeve e kadrove drejtues të ishte e cekët e formale. Dobësi të tilla pengonin revolucionarizimin e mëtejshëm të Partisë.

«Revolucionarizimi i Partisë, — mësonte shoku Enver Hoxha, — nuk mund të bëhet veçse nëpërmjet rrugës së njohjes si duhet të kuptimit të thellë filozofik dhe të zbatimit me rreptësi e në mënyrë revolucionare të parimeve marksiste-leniniste që udhëheqin Partinë dhe të normave leniniste që rregullojnë jetën e saj dhe të komunistëve.

«Kjo çështje e madhe jetike nuk mund të kuptohet formalisht dhe këto parime nuk mund të lejojmë të zbatohen mekanikisht, të mësohen si formula pa shpirt dhe pa jetë»¹.

Duke u mbështetur në këtë mësim dhe në orientimet e Kongresit V, vëmendja e Partisë u përqendrua veçanërisht në disa drejtime.

↑ Iu kushtua kujdes gjallërimit, thellimit të frymës revolucionare të organizatave-bazë. Komunistëve iu kërkua të vinin më të përgatitur në mbledhje, të shtronin me guxim mendimet e tyre, të bënin vërejtje, të kritikonin, të parashikonin, të propozonin, duke i kërkuar më parë llogari vetes, pastaj edhe shokëve. U goditën rastet e qëndrimeve oportuniste për të mos kritikuar shokun ose eporin për arsye familjariteti, konformizmi, servilizmi, gjithashtu edhe për arsye frike nga hakmarrja. U morën masa të rrepta kundrejt atyre që shfrytëzonin postin drejtues për t'u hakmarrë me mënyra të ndryshme ndaj kritikuesve. Ndërkaq, u punua për ta bërë më të qartë se nuk mund të qëndrosh komunist në qoftë se ke frikë të kritikosh e të shprehësh hapur për çdo gjë atë që mendon, as po të shtypësh kritikën dhe mendimet e shokëve. Si rrjedhim u rrit roli i organizatave-bazë si vatra edukimi e kalitjeje revolucionare dhe si organizma udhëheqëse.

Një çështje për të cilën ishte treguar e do të tregohej kujdes i vazhdueshëm ishte ruajtja dhe forcimi i unitetit ideologjik e organizativ të Partisë. Për këtë çështje jetësore Komiteti Qendror kërkonte të tregohej orë e çast vigjilenca më e madhe.

Një nga pikësynimet e vazhdueshme të armiqve të jash-tëm e të brendshëm është prishja e unitetit në Parti. Revizionistët sovjetikë, titistë etj. nuk linin mjet e mënyrë pa përdorur për të tronditur themelet e unitetit të çeliktë tradicional të PPSH, të krijonin të çara në radhët e saj, ku mund të kape-shin për ta kthyer atë nga rruga marksiste-leniniste në rrugën revizioniste. Veç kësaj, Mao Ce Duni, i cili prej kohësh e kishte ngritur në teori praninë e fraksioneve e të vijave të kundërta dhe luftën midis vijave në gjirin e partisë, si një fenomen objektiv, me anë të Çu En Lait, kur ky ndodhej për një vizitë

¹ Enver Hoxha. Fjala e 6 shkurtit 1967. Raporte e fjalime 1967-1968. f. 22.

në Shqipëri, në qershor 1966, bëri përpjekje që këtë «teori» antimarksiste t'ia impononte edhe Partisë së Punës të Shqipërisë.

PPSH, duke zbatuar parimin e madh të unitetit të partisë marksiste-leniniste, nuk kishte lejuar asnjëherë të kristalizoheshin në gjirin e saj rryma fraksioniste e vija të kundërta revizioniste, i kishte zbuluar dhe i kishte shkatërruar me kohë me luftë parimore revolucionare elementët dhe pikëpamjet armiqësore, grupet fraksioniste antiparti, pa u dhënë atyre mundësi të shndërroheshin në rryma e vija të kundërta. Duke bërë përgjithësimin e kësaj përvoje, dhe duke i dhënë tërthorazi përgjigje udhëheqjes kineze, shoku Enver Hoxha deklaronte: «Një parti marksiste-leniniste, që respektohet si e tillë, nuk mund të lejojë ekzistencën e dy vijave në parti; nuk mund të lejojë, pra, ekzistencën e fraksionit ose të shumë fraksioneve. Edhe në qoftë se shfaqet një gjë e tillë, partia nuk mundet dhe nuk duhet ta lejojë, qoftë edhe për një kohë të shkurtër, ekzistencën e tyre. Fraksioni në parti është në kundërshtim me unitetin e mendimit e të veprimit marksist-leninist dhe përpiqet ta kthejë partinë në një parti socialdemokrate dhe vendin socialist në një vend kapitalist»¹. Praktika ka vërtetuar se kristalizimi i ideologjive dhe i vijave të kundërta në një parti tregon se ajo parti ose nuk është me të vërtetë marksiste-leniniste ose, duke qenë e tillë, nuk e ka zhvilluar drejt, në mënyrë konsekuente e të vendosur luftën e klasave në gjirin e vet.

Për ruajtjen e forcimin e unitetit të Partisë, sipas ideve të Kongresit dhe mësimëve të shokut Enver Hoxha, lufta u përqendrua kryesisht në zbatimin revolucionar të parimeve e të normave të partisë proletare. Duke luftuar shfaqje të shkeljeve të këtyre parimeve e normave, u goditën edhe rastet e grindjeve, të tarafeve, të ndikimit fisnor e të miqësisë së sëmurë, që shërbejnë si truall për moszbatimin e Statutit, për dobësimin e unitetit të mendimit e të veprimit dhe për veprimtari armiqësore në organizatë, që nuk e lejojnë këtë të luajë rolin udhëheqës.

Një çështje kapitale që i dha hov të ri revolucionarizimit të Partisë ishte pranimi i anëtarëve të rinj. Kongresi V u kishte tërhequr vëmendjen atyre organizatave të partisë që nuk kishin

¹ Enver Hoxha. Fjala e 6 shkurtit 1967. Raporte e fjalime 1967-1968, f. 40.

pranuar komunistë të rinj për një kohë të gjatë. Në vitet 1965 dhe 1966 Partia ishte shtuar përkatësisht vetëm 1,9 dhe 0,2 për qind. Kjo ishte një rritje krejt e pakënaqshme. Edhe në vitin 1967, me gjithë kërkesat këmbëngulëse të Komitetit Qendror, rritja e saj prej 2,7 për qind ishte e vogël.

Në analizën që i bëri Komiteti Qendror këtij problemi shoku Enver Hoxha thoshte: «Kjo, shokë, është një çështje shumë serioze, është një gabim i rëndë që po bëjmë...»¹ Pastaj ai kërkonte që këtij problemi t'i hyhej seriozisht, ta studionte atë çdo organizatë dhe komitet partie për ta zgjidhur. Çështjen e pranimeve të reja në Parti e studioi edhe vetë Komiteti Qendror në shkallë të gjithë Partisë, duke dhënë, mbi këtë bazë, orientimet e nevojshme. Të gjitha këto sollën rritjen e tempit të pranimeve. Gjatë pesë vjetëve 1967-1971 u shtuan 20 658 komunistë. Partia u rrit kështu gjatë kësaj periudhe 31 për qind, kurse në pesëvjeçarin e mëparshëm shtesa kishte qenë vetëm 3,24 për qind.

Por sukcesi më i madh ishte forcimi i përbërjes punëtore të Partisë. Për herë të parë në vitin 1970 komunistët me gjendje shoqërore punëtorë dolën në vendin e parë me 36,08 për qind, përpara komunistëve nëpunës (34,68 për qind) dhe fshatarë kooperativistë (29,24 për qind). Kjo dëshmonte për kujdesin e madh që tregonte Partia për të qenë proletare jo vetëm nga ideologjia, por edhe nga përbërja klasore e saj. Është edhe ky një tipar që e dallon PPSH, si parti revolucionare e klasës punëtore, nga partitë revizioniste, ku mbisundojnë nga çdo pikëpamje, edhe nga përbërja shoqërore, nëpunësit burokratë dhe teknokracia.

Në vitet 1967-1971 u krye një ndryshim cilësor edhe në përbërjen shoqërore të organeve udhëheqëse të Partisë. Në analizën që i bëri në fund të vitit 1967 kësaj çështjeje, Komiteti Qendror i Partisë e cilësonte të parregullt faktin që ndër 1 450 anëtarë plenumesh të komiteteve të partisë vetëm 220 ishin punëtorë. Po kështu paraqitej e pakënaqshme përbërja e byrove të komiteteve të partisë. Pakëz më e mirë ishte përbërja shoqërore e byrove dhe e sekretarëve të organizatave-bazë, por prapë jo ajo që nevojitej.

¹ Enver Hoxha. Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit të KQ të PPSH, 21 prill 1967. Raporte e fjalime 1967-1968, f. 84.

Udhëheqja e Partisë nxori konkluzionin se ishte e domosdoshme të përmirësohej përbërja shoqërore e organeve udhëheqëse dhe dha për këtë qëllim orientimet përkatëse. Në bazë të këtyre orientimeve gjendja ndryshoi që në zgjedhjet në Parti të vitit 1968, kurse në vitin 1971 u arrit që 55 për qind e anëtarëve të plenumeve të komiteteve të partisë të ishin punëtorë me gjendje, prejardhje dhe origjinë. Në byrotë e organizatave-bazë të ndërmarrjeve ekonomike punëtorët zinin 85,2 për qind dhe sekretarët e tyre — 86,3 për qind. Kjo kishte një domethënie të madhe parimore për t'i mbyllur shtegun degjenerimit borgjez të organeve udhëheqëse të Partisë, për të mënjeluar të keqen që e zuri për fyti Partinë Komuniste të Bashkimit Sovjetik, ku organet udhëheqëse u mbushën me intelektualë e nëpunës burokratë e teknokratë, të cilët ia rrëmbyen më në fund pushtetin politik nga duart klasës punëtore.

Përmirësime të dukshme u realizuan edhe në shtrirjen e shpërndarjen e forcave të Partisë. Më 1971 nuk kishte ngelur kështu asnjë repart ndërmarrjeje shtetërore dhe sektor kooperative bujqësore pa organizatë-bazë, asnjë fshat pa komunistë. 61 për qind e komunistëve punonin në sferën e prodhimit material, ndër këta 80 për qind drejtpërdrejt në prodhim. Afër 2000 komunistë, duke iu përgjigjur thirrjes së Partisë, kishin kaluar vullnetarisht nga administrata në prodhim, nga frontet e lehta në frontet më të vështira, nga qyteti në fshat. Kjo i jepte një goditje të rëndë konceptit jomarksist, sipas të cilit, «të jesh komunist duhet të kesh medoemos funksione zyrtare».

Gjithë lufta për revolucionarizimin e Partisë kishte një karakter të theksuar edukimi revolucionar jo vetëm për anëtarët e Partisë, por edhe për masat e gjera. Kjo luftë nuk ishte vetëm një shprehje e zbatimit me besnikëri e në mënyrë krijuese e marksizëm-leninizmit, por edhe e mësimit të teorisë marksiste-leniniste të lidhur ngushtë me praktikën revolucionare.

Si armë shumë të rëndësishme të luftës për revolucionarizimin si edhe për edukimin ideopolitik revolucionar të komunistëve e të masave popullore shërbyen «Historia e Partisë së Punës të Shqipërisë», që u botua në vitin 1968 dhe Veprat e shokut Enver Hoxha, dy vëllimet e para të të cilave dolën gjithashtu në atë vit. Deri më 1971 qenë botuar tetë vëllime të këtyre Veprave, që do të vazhdonin në të ardhmen edhe në shumë vëllime të tjera. Në këtë periudhë u botuan edhe dy vëllime të reja (III dhe IV) me dokumentet kryesore të Partisë, kurse vë-

llimi I u ribotua. Për herë të parë filloi botimi në shqip i veprës gjeniale të K. Marksit «Kapitali» (në vitin 1968-1971 u botuan tri librat e vëllimit I); u botuan ose u ribotuan edhe 35 vëllime të tjera me vepra të K. Marksit, F. Engelsit, V. I. Leninit dhe J. V. Stalinit.

Lufta komplekse për revolucionarizimin e Partisë dha mësimë shumë të vlefshme për ta ngritur punën drejtuese, organizuese, edukuese të Partisë në një shkallë më të lartë, në përputhje me detyrat e mëdha e të vështira që shtroreshin përpara në rrugën e ndërtimit të plotë të shoqërisë socialiste.

Revolucionarizimi i mëtejshëm i pushtetit

Vëmendja kryesore për revolucionarizimin e mëtejshëm të pushtetit shtetëror,

në bazë të orientimeve të Kongresit V, u përqendrua në vazhdimin e luftës kundër burokratizmit.

Kishte rrezik që lufta kundër burokratizmit të quhej e përfunduar ose të ngadalësohej pas fushatës që u zhvillua me aq vrull gjatë vitit 1966. Për t'i dalë përpara një rreziku të tillë shoku Enver Hoxha, në fjalën e tij të 6 shkurtit 1967, qëndroi në mënyrë të veçantë në domosdoshmërinë e vazhdimin të luftës kundër burokratizmit duke theksuar se «kjo luftë nuk do të mbarojë kurrë, përderisa do të ekzistojnë klasat dhe lufta e klasave ajo do të jetë e vazhdueshme»¹. Veç kësaj, ai theksoi prapë se lufta kundër burokratizmit, për të qenë e frytshme, para së gjithash, është e nevojshme të kuptohet drejt si një luftë për çrrënjosjen e koncepteve idealiste, antimarksiste, reaksionare, si edhe të praktikave antipopullore në çështjen e qeverisjes, që burojnë nga ato koncepte. Ajo është një luftë e ashpër për politike, ideologjike, organizative, në të cilën marrin pjesë drejtpërdrejt masat nën udhëheqjen e Partisë, duke goditur fort konceptet dhe shtrembërimet burokratike, burokratët, pavarësisht nga pozita e nga grada. Burokratizmi dhe burokratët janë armiq të popullit, janë armiqtë më të këqij e më dinakë të partisë marksiste-leniniste dhe, «si të tillë, ajo duhet t'i luftojë vazhdimisht, me këmbëngulje, pa pushim»².

1 Enver Hoxha. Raporte e fjalime 1967-1968, f. 42.

2 Po aty, f. 43.

Ky theks i fortë që vinte përsëri udhëheqja e Partisë në luftën kundër burokratizmit, siguroi që kjo luftë të merrte karakterin e një lëvizjeje të gjerë popullore, thelbi i së cilës ishte forcimi i diktaturës së proletariatit.

Pjesëmarrja e drejtpërdrejtë e masave në luftën kundër burokratizmit bënte të domosdoshme forcimin e përsosjen e kontrollit të masave, veçanërisht të kontrollit punëtor mbi organet, aparatet dhe kuadrot e pushtetit e të ekonomisë.

Ky kontroll gati ishte katandisur në disa komisione, të cilat vetëm emrin e kishin «të kontrollit punëtor», kurse në të vërtetë drejtimi i tyre ishte në dorë të njerëzve të administratës. Duke kritikuar këtë kuptim kaq të ngushtë të kontrollit punëtor, në prill të vitit 1968, Komiteti Qendror u ndal në mënyrë të posaçme në këtë çështje të madhe parimore: «Problemi... është më i madh dhe më i gjerë se çështja e komisioneve të punëtorëve. Udhëheqja e kontrolli nga ana e klasës punëtore dhe e Partisë mbi çdo gjë dhe mbi këdo, mbi kuadrot, forumet, administratat, komisionet, duhet të jenë të plotë, pa të çara, vendimtarë»¹.

Realizimi i plotë i kontrollit të klasës punëtore dhe të masave të tjera punonjëse jo vetëm teorikisht por edhe praktikisht është një kusht vendimtar për luftën me sukses kundër burokratizmit e kundër të gjitha shfaqjeve të tij në formën e teknokratizmit e të intelektualizmit, ekonomizmit etj.

Zbatimit të direktivës së Kongresit V për luftën kundër burokratizmit dhe për forcimin mbi baza revolucionare të kontrollit punëtor i dhanë një shtytje të re vendimet e Plenumit të KQ të Partisë të shtatorit 1968.

Në bazë të orientimeve të Komitetit Qendror, si rrjedhim i luftës së organizatave të partisë për të zbatuar këto orientime, u zgjerua e mori një gjallërim të ri pjesëmarrja e masave në qeverisjen e vendit dhe në drejtimin e ekonomisë. U spas-trua kontrolli punëtor nga elementet burokratike. U braktisën të ashtuquajturat «komisione të punëtorëve», sepse qenë shndërruar në forma burokratike, po ashtu edhe «treshja» e përbërë nga drejtori, sekretari i organizatës së partisë dhe krye-

¹ Enver Hoxha. Fjala në Sekretariatën e KQ të PPSH, 9 prill 1968. Raporte e fjalime 1967-1968, f. 394.

tari i komitetit profesional, një tjetër formë burokratike, e cila nën maskën e «drejtimit operativ», shkelte demokracinë, rregullat, vijën e Partisë. Këto forma, që cenonin direktivat e Partisë për rolin udhëheqës të klasës punëtore, u zëvendësuan me metoda e forma të reja të kontrollit të drejtpërdrejtë punëtor. Kjo u shoqërua me shtimin e kujdesit për edukimin e punëtorëve me ideologjinë dhe guximin revolucionar të klasës.

Me pjesëmarrjen e masave të gjera popullore në luftën kundër burokratizmit e në të gjitha çështjet e qeverisjes përmes kontrollit të tyre, veçanërisht të kontrollit të klasës punëtore, u shënuan përparime të rëndësishme në revolucionarizimin e pushtetit shtetëror.

Në organet përfaqësuese të pushtetit u zgjodhën më shumë njerëz nga prodhimi, të sprovuar për besnikëri ndaj popullit e socializmit, për vendosmëri, guxim e shpirt luftarak në mbrojtjen dhe zbatimin e vijës së Partisë dhe të ligjeve të shtetit.

U shënuan një rritje e autoritetit dhe në përgjithësi e rolit të organeve të zgjedhura përfaqësuese të pushtetit. Komitetet ekzekutive të këshillave popullore dhe aparatet përkatëse u vunë më mirë nën kontrollin e tyre. U vendos gjithkund raportimi e dhënia e llogarisë në mënyrë të rregullt nga organet ekzekutive e urdhërdhënëse përpara organeve të zgjedhura, si edhe nga këto të fundit përpara zgjedhësve.

Organet e zgjedhura e përsosën punën e tyre jo vetëm për marrjen e vendimeve e miratimin e ligjeve, por edhe për ndjekjen e zbatimit të tyre, nëpërmjet një organizimi më të mirë të punës, një ndarjeje pune më të studiuar dhe një aktivizimi më të madh të deputetëve e të këshilltarëve.

U bë një rishikim i përgjithshëm i legjislacionit. Si rezultat i këtij rishikimi, u shfuqizuan përmbi 400 akte ligjore. Ato u zëvendësuan me akte më të thjeshta, më të përmbledhura, më të studiuar në përputhje me kushtet e reja. Projektet e ligjeve më të rëndësishme, të rihartuara, iu nënshturuan gjykimit të masave popullore. Në të njëjtën kohë u zgjerua edhe tërheqja e masave punonjëse në hetimin dhe gjykimin e çështjeve penale. Realizimi i këtij qëllimi i shërbeu veçanërisht krijimi i gjykatave të fshatrave, të qyteteve e të lagjeve.

Por revolucionarizimi i mëtejshëm i pushtetit nuk bëhej pa pengesa. Ai haste në vështirësi, madje edhe në kundërshtimin e fshehtë, ndonjëherë edhe të hapët, të burokratizmit e të

burokratëve, të cilët gjenin gjithfarë mënyrash për të penguar zbatimin deri në fund të vendimeve e të direktivave të Partisë mbi shkurtimin dhe thjeshtimin e aparatit shtetëror dhe mbi tërheqjen e masave të gjera në qeverisje e në drejtimin e ekonomisë.

Komiteti Qendror vuri re se dikasteret qendrore dhe administratat e ndërmarrjeve të ndryshme kishin bërë shumë shtesa në organikat, pas shkurtimit të tyre me vendimin e Partisë të dhjetorit 1965 për luftën kundër burokratizmit. Ai i quajti këto shtesa të parregullta dhe ngarkoi (në shkurt 1970) Këshillin e Ministrave të shqyrtonte një për një shtesat e bëra, për të kryer përsëri shkurtimet e mundshme e të nevojshme. Ndërkaq, udhëzoi komitetet dhe organizatat e partisë të kishin më shumë kujdes e të zhvillonin më shumë përpjekje për zbatimin e direktivave të Partisë për luftën kundër burokratizmit, duke u mbështetur më fuqimisht te masat, duke i aktivizuar më efektivisht ato në këtë luftë.

Praktika e luftës kundër burokratizmit për revolucionarizimin gjithnjë e më shumë të pushtetit nxori të domosdoshme përsosjen e drejtimit dhe zgjerimin e mëtejshëm të kompetencave të organeve shtetërore dhe ekonomike.

Pas shqyrtimit që i bëri kësaj çështjeje në dhjetor të vitit 1970, Komiteti Qendror vendosi të merreshin masa për të zgjeruar kompetencat e komiteteve ekzekutive të këshillave popullore, të ndërmarrjeve shtetërore, të kooperativave bujqësore dhe institucioneve të tjera të bazës, por pa cenuar parimin themelor të centralizmit demokratik të drejtimit. Ndërkaq, organikat e dikastereve e të institucioneve të tjera shtetërore qendrore u shkurtuan më tej; kurse kuadrot që përfshinte ky shkurtim shkuan në bazë.

Këto masa nuk kishin domethënien e ndonjë ndryshimi rrënjësor në organizimin shtetëror, e kryerjes së ndonjë reforme. Ato përbënin një thellim të mëtejshëm të demokratizimit të pushtetit, një përmirësim të drejtimit të punëve shtetërore dhe ekonomike. Ato diktoheshin nga stadi i ri i zhvillimit të shoqërisë socialiste, kur qenë forcuar, qenë zgjeruar e qenë përsosur marrëdhëniet socialiste në prodhim, qe zhvilluar e qe forcuar baza materialo-teknike, qe ngritur e qe forcuar ndërgjegjja socialiste e klasës punëtore dhe e fshatarësisë kooperativiste, qe rritur e qe forcuar inteligjencia popullore, qe fituar një përvojë e pasur drejtimi në bazë.

Njëkohësisht, Partia i kushtoi një vëmendje të madhe edhe punës për revolucionarizimin e Ushtrisë Popullore, të Forcave të Kufirit, të Policisë Popullore e të Sigurimit të Shtetit.

Puna e zhvilluar për këtë qëllim solli një afrim e një lidhje më të ngushtë të tyre me masat e popullit, një përgatitje më të shëndoshë profesionale, sidomos një përgatitje më të thellë ideopolitike revolucionare.

Vetëm në ushtri vihej re një formalizëm i theksuar në zbatimin e vendimeve revolucionare të KQ të Partisë të vitit 1966 për Forcat e Armatosura dhe të direktivave të tjera për revolucionarizimin e mëtejshëm të jetës së vendit. Komiteti Qendror me shoqun Enver Hoxha e kishin kritikuar shpesh këtë dukuri. Siç doli më vonë, ky formalizëm i kishte rrënjët në përpjekjet e armiqve në ushtri për të sabotuar këto vendime e direktiva. Ata bënë zhurmë të madhe sikur në ushtri masat revolucionarizuese zbatoheshin më mirë se kudo gjetkë, për të mashtruar kështu Partinë e për të mbuluar gjurmët e tradhtisë, e cila do të zbulohej e do të shkatërrohej në vitet e ardhshme.

Çelikosja e mëtejshme e unitetit Parti-popull

Ruajtjen dhe forcimin e bashkimit të popullit rreth saj Partia e ka parë si një proces të va-

zhdueshëm, të lidhur me etapat dhe kushtet konkrete historike të revolucionit. Baza politike e këtij bashkimi, që u hodh në Luftën Antifashiste Nacionalçlirimtare, erdhi gjithnjë duke u forcuar në luftën për ndërtimin e socializmit. Pas çlirimit të vendit bashkimi politik i popullit u pajis edhe me bazën e vet ekonomiko-shoqërore socialiste. U forcua gjithashtu baza ideologjike e tij me rrënjosjen gjithnjë e më shumë në ndërgjegjen e njerëzve të ideve marksiste-leniniste e të moralit proletar. Ai u kalit dhe u shndërrua kështu në një unitet të çeliktë të masave punonjëse (të klasës punëtore, të fshatarësisë kooperativiste e të inteligjencias popullore) me Partinë.

Rrugët për forcimin e mëtejshëm të unitetit të popullit rreth Partisë, në kushtet e ndërtimit të plotë të shoqërisë socialiste, u përpunuan nga shoku Enver Hoxha dhe u shtruan në Kongresin IV të Frontit Demokratik që u mbajt në shtator 1967.

Uniteti kalitet nëpërmjet një pune të gjerë sqaruese e bindëse me masat për kuptimin e thellë të përmbajtjes politike

dhe ideologjike të vijës, të çdo direktive të Partisë, nëpërmjet mobilizimit të popullit për zbatimin e tyre në jetë. Partia kërkonte nga të gjitha organizatat e saj të hiqej dorë nga puna e mbyllur, të informonin rregullisht masat për vendimet që merrnin, t'i sqaronin për këto vendime, të dëgjonin më gjerësisht dhe me më tepër vëmendje zërin e tyre, kritikën e tyre, të jepnin llogari përpara masave, të fshikullonin ashpër të gjithë ata komunistë e kadro, që duke e hequr veten gjoja mbrojtës të parimit, të ligjit, nuk ua vinin veshin ose, edhe më keq, mbytnin zërin dhe kritikën e masës.

Uniteti çelikoset duke luftuar për forcimin e vazhdueshëm të pushtetit popullor, për demokratizimin e tij të mëtejshëm duke siguruar një pjesëmarrje më të gjallë të masave në qeverisjen e vendit.

Uniteti forcohet në luftën për plotësimin e detyrave të mëdha, për zhvillimin e ekonomisë e të kulturës.

Uniteti forcohet duke rrënjosur gjithnjë e më thellë në zemrat e në ndjenjat e masave dashurinë e besnikërinë ndaj atdheut socialist, duke mbajtur gjithmonë të gjalla e duke zhvilluar më tej traditat patriotike e revolucionare të popullit shqiptar, duke forcuar pa pushim urrejtjen kundër armiqve të klasës, kundër imperialistëve e revizionistëve, duke rritur vazhdimisht gatishmërinë moralo-politike, ekonomike dhe ushtarake të popullit për mbrojtjen e vendit.

Por hallka kryesore për forcimin e mëtejshëm të unitetit të popullit rreth Partisë në etapën e re të ndërtimit të plotë të shoqërisë socialiste, theksoi shoku Enver Hoxha, është «lufta për rrënjosjen dhe triumfin e plotë të ideologjisë proletare në ndërgjegjen e gjithë punonjësve».¹ Forcimi i bazës ideologjike të unitetit të popullit sjell drejtpërdrejt forcimin e bazës politike dhe ekonomiko-shoqërore të tij, siguron zgjidhjen e detyrave të Partisë në lëmin politik, ekonomiko-shoqëror, kulturor dhe të mbrojtjes.

Forcimi i unitetit bëhet nëpërmjet luftës së klasave, zgjidhjes së drejtë revolucionare të kontradiktave në shoqërinë socialiste. «Ta marrësh çështjen e unitetit jashtë luftës së klasave, të mohosh gjoja për hir të këtij uniteti luftën e klasave. . . , do

1 Enver Hoxha. Raport mbajtur në Kongresin IV të Frontit Demokratik të Shqipërisë. Raporte e fjalime 1967-1968, f. 185.

të thotë të vesh në gjumë vigjilencën politike e ideologjike të Partisë e të punonjësve, të minosh vetë unitetin dhe çështjen e socializmit»¹.

Por është e nevojshme të tregohet kujdes i madh për të bërë mirë dallimin e kontradiktave antagonistë ndërmjet popullit e armiqve të klasës dhe të kontradiktave joantagoniste në gjirin e popullit, për të mos ngatërruar me armiqtë njerëzit që ruajnë në ndërgjegjen e tyre koncepte të huaja, por që janë besnikë ndaj Partisë dhe socializmit. Përndryshe, dëmtohet uniteti dhe dobësohen lidhjet e Partisë me masat.

Mishërimi i unitetit të popullit rreth Partisë mbetet gjithmonë Fronti Demokratik. Përvoja 25-vjeçare e Frontit kishte vërtetuar rëndësinë e madhe të kësaj organizate për të krijuar, për të ruajtur dhe për të forcuar vazhdimisht lidhjet e çelika të Partisë me masat, për t'i mobilizuar ato në zbatimin e programit të Partisë, për të kapërcyer vështirësitë, për të mundur armiqtë dhe për të arritur fitoren. Partia shtronte detyrë që Fronti Demokratik të forcohej në pikëpamje organizative, të rritej fryma luftarake e vetëvepruese e organizatave të tij, të përmirësohej metoda dhe stili i punës së këtyre organizatave. Gjallërimi dhe forcimi i mëtejshëm i Frontit shërbente si një mjet kryesor për revolucionarizimin e mëtejshëm të jetës së vendit.

Rëndësi të veçantë teorike e praktike ka përgjithësimi që bëri shoku Enver Hoxha në Kongresin IV të Frontit për vendin e rolit të partisë marksiste-leniniste në frontin e përbashkët të forcave patriotike revolucionare e socialiste. Trajtimi i këtij problemi kishte qëllim të demaskoheshin pikëpamjet antimarksiste dhe taktikat mashtruese të revizionistëve të ndryshëm, të cilët mbrojnë e përhapnin me zell pluralizmin ideologjik e politik, kompromiset tradhtarë me partitë borgjeze, pikëpamje e taktika që drejtoheshin kundër rolit hegjemon të klasës punëtore e kundër udhëheqjes së partisë proletare, që synonin përjetësimin e sistemit kapitalist.

Është i njohur fakti që Fronti në Shqipëri u krijua dhe mbeti kurdoherë një bashkim vullnetar i drejtpërdrejtë i masave rreth Partisë së klasës punëtore dhe jo një koalicion partitish politike, si në vendet e tjera ku kishte pasur ose kishte një

1. Enver Hoxha. Raport mbajtur në Kongresin IV të Frontit Demokratik të Shqipërisë. Raporte e fjalime 1967-1968, f. 182.

front kombëtar patriotik revolucionar. Te ne s'kanë ekzistuar parti të tjera politike, veç Partisë Komuniste (të Punës) të Shqipërisë dhe kjo, siç u shpreh shoku Enver Hoxha, ka qenë «një e mirë e madhe e pallogaritshme, kurse për borgjezinë, për reaksionin kombëtar e ndërkombëtar, ishte një fatkeqësi e madhe, një humbje fatale».¹ Kjo nuk do të thotë që PPSH ka qenë në parim kundër bashkëpunimit me parti antifashiste, përparimtare, në rast se parti të tilla do të formoheshin, duke bërë me to front të përbashkët kundër armikut të përbashkët, fashizmit pushtues e tradhtarëve të vendit, por pa hequr dorë nga individualiteti dhe pavarësia e vet politike, ideologjike, organizative dhe nga fitimi e ruajtja e rolit udhëheqës në revolucion nëpërmjet bindjes së masave në drejtësinë e vijës së saj.

Mirëpo sa kohë mund të zgjatë ekzistenca e partive politike joproletare, bashkëpunimi dhe bashkimi i partisë së klasës punëtore me to në një front të përbashkët? Kësaj çështjeje parimore i dha përgjigje shoku Enver Hoxha duke u mbështetur në teorinë marksiste-leniniste e në përvojën e revolucioneve socialiste që ishin zhvilluar deri atëherë. «Pasi është vendosur dhe konsoliduar diktatura e proletariatit..., — tha ai, — ekzistenca për një kohë të gjatë e partive të tjera, në front dhe jo në front, qofshin këto edhe «përparimtare», nuk ka asnjë kuptim, asnjë arsye, qoftë edhe formalisht gjoja për shkak të traditave të tyre... Revolucion i përmbys një botë të tërë dhe jo më një traditë... Do të ishte absurde dhe oportuniste prania e partive të tjera jomarksiste-leniniste..., sidomos pas ndërtimit të bazës ekonomike të socializmit. Kjo nuk e cenon aspak demokracinë, por përkundrazi forcon demokracinë e vërtetë proletare. Karakteri demokratik i një rendi nuk matet aspak me numrin e partive, por përcaktohet nga baza e tij ekonomike, nga klasa që është në fuqi, nga gjithë politika dhe veprimtaria e shtetit, nëse ajo është në interes të masave të gjera të popullit dhe nëse u shërben ose jo atyre»². Të lejosh praninë e partive të tjera politike pas kësaj, do të thotë të ruash borgjezinë si klasë.

Ky konkluzion drejtohej edhe kundër teorive të Mao Ce Dunit mbi praninë e bashkëjetesës së shumë partive, mbi shu-

1 Enver Hoxha. Raporte e fjalime 1967-1968, f. 157.

2 Po aty, f. 176-177.

më vija në partinë komuniste, mbi lulëzimin e njëqind luleve e konkurrimit e njëqind shkollave në revolucion e në socializëm.

Në Shqipërinë socialiste bashkimi vullnetar i drejtpërdrejtë i popullit në Frontin Demokratik, nën udhëheqjen e vetme të Partisë së Punës të Shqipërisë, mbetej kurdoherë garanci për ruajtjen e fitoreve të mëdha revolucionare të arritura dhe për fitore të reja në rrugën e socializmit e të komunizmit.

3. LËVIZJET E MËDHA REVOLUCIONARE

Fjala e shokut Enver Hoxha e 6 shkurtit 1967 dhe gjithë lufta e Partisë për të vënë në jetë vendimet e Kongresit V i dhanë edhe më shumë zjarr veprimtarisë revolucionare të masave punonjëse. I madh e i vogël u ngrit në këmbë, duke kritikuar me guxim veten dhe të tjerët, për të luftuar të metat, dobësitë e gabimet, për të spastruar shoqërinë socialiste nga mbeturinat e shoqërisë së vjetër dhe nga ndikimet e ideologjisë borgjezo-revizioniste, për të rrënjosur në punë e në jetë normat e qëndrimet revolucionare socialiste, mësimet proletare të Partisë. Shpërthyen iniciativa të mrekullueshme të punonjësve, që u mishëruan në një shumicë aksionesh konkrete, u shndërruan në lëvizje të mëdha revolucionare.

Këto lëvizje ishin një rrjedhim i drejtpërdrejtë i vijës marksiste-leniniste, i tërë punës e luftës revolucionare të Partisë, të mëparshme dhe aktuale, për zhvillimin e pandërprerë të revolucionit socialist.

Në krye të këtyre lëvizjeve qëndronte klasa punëtore me partinë e saj marksiste-leniniste.

Lëvizja për të vënë gjithkund interesin e përgjithshëm mbi interesin vetjak

Thelbi i kësaj lëvizjeje ishte sulmi i përgjithshëm kundër psikologjisë mikroborgjeze për rritjen e ndër-

gjegjes socialiste të punonjësve.

Duke u mbështetur në përparimin e madh të arritur pas Çlirimit në formimin e njeriut të ri me botëkuptimin revolucionar, Partia e quante të domosdoshme t'i jepte një shtytje të re të fuqishme luftës kundër koncepteve e qëndrimeve mikroborgjeze, të cilat përbëjnë një pengesë të madhe në rrugën e